

YMER MINXHOZI

SHQETËSIMET

E

Cher Patersonit

SSH-2

M 78



891.983-7

S

M 78

YMER MINXHOZI

Shqetësimet
e Xhek Datersonit

— FEJTONE E PAMFLETE —

~~4.1.70~~

204574

SHËNIMET E SHËNIT
GJITHGJITHSHT

SHËNITIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

ZGJEDHJA E NJË PRESIDENTI

Shumë zhurmë për asgjë

Një herë në katër vjet amerikanëve iu jepet mundësia të bëjnë historinë. Gjatë disa muajve, nga një ditë në tjetrën, atmosfera politike vjen duke u nxehur dhe të gjithë presin çfaqjen e premierës. Kasat janë të hapura, amerikani (nëqoftëse nuk është zezak ose i papunë) merr biletën dhe asiston në çfaqjen më të madhe të komedisë së vendit të vet.


Emrat e heronjve të komedisë ai i ka mësuar jo vetëm nëpërmjet shtypit, radios e televizionit, por i ka parë edhe në kutitë e sapunit, në pastat e dhëmbëve e basmat e fustaneve, në të mbathurat e fëmijëve dhe në kapellat e senatorëve. Ata i lexon edhe në qiellin e Nju Jorkut të formuar nga skuadrilje aeroplanash. Nuk është shaka: është fjala për zgjedhjet presidenciale! Çdo gjë është organizuar në mënyrë të përsosur: qytetari amerikan bie të flerë me emrin e Niksonit dhe ngrihet në mëngjes, duke folur për Kenedin. Vetë Ajzenhaueri, i cili së shpejti do të jetë një eks-president, paraqitet në konferencat e shtypit dhe në ekranet e televizionit,

duke mbajtur në gjoks një distinktiv në madhësinë e një pjate gjelle ku janë shkruar emërat e kandidatëve të partisë së tij.

Pronarët e «shtypit të lirë» janë njerëz të kujdesshëm: ata nuk lenë jashtë vemendjes së tyre edhe gratë e kandidatëve — Zhakin dhe Petin. Bile ndonjëherë flitet me aqë hollësi e pasion për gustot, simpatitë dhe antipatitë e tyre sa që kujton se pikërisht ato do të zgjidhen presidente, e jo burrat e tyre. Midis qarqeve gazetareske bëhen anketa se kush ka më shumë simpatizantë: gruaja e Niksonit apo e Kenedit.

Me zhvillimin e çfaqjes, dalin në skenë edhe vetë heronjtë kryesorë të komedisë, — kandidatët për presidentë. Rreth tyre bëhet zhurmë. Edhe ata vetë bëjnë zhurmë. Ndonjëherë ata shahen aqë keq njeri me tjetrin, sa që mendon se nesër do të bëjnë duel midis tyre. Kandidati i partisë republikane e akuzon kandidatin e partisë demokratike, se ai është ende shumë i ri dhe prandaj nuk ka kokë për kolltukun e Shtëpisë së Bardhë. Kandidati i partisë demokrate, nga ana e tij, i thotë kundërshtarit se me të vërtetë ai është disa vjet më i vjetër, por nga koka ka mbetur kalama. Përkrahësit e Niksonit thonë se Kenedi është i aftë vetëm për aventura të vogla, ndërsa miqtë e Kenedit thonë se pas zgjedhjeve kanë gjetur një punë të përshtatshme për Niksonin, në një park për zbatimjen e fëmijëve.

Po të gjykosh sipas zhurmës krijon përshtypjen se republikanët dhe demokratët ndjekin dy vija krejt të kundërta, të cilat kanë për qëllim ta ndryshojnë krejtësisht jetën e Amerikës. Kur vijmë



— E, Xhejms, cila të pëlqen? Niksoni apo Kenedi?

tek krahasimi i programeve elektorale të të dy partive, atëhere duket menjëherë se republikanët dhe demokratët i sulen njeri tjetrit me shpata prej kartoni. Midis programit elektorale të republikanëve dhe programit elektorale të demokratëve është shumë zor të heqësh qoftë edhe një vijë të hollë, megjithëse gjatë zgjedhjeve amerikane, kandidatët janë të lirë të bëjnë çfardollosj të premtimi.

Revista amerikane «Riders Deixhest» i paguan çdo amerikani pesë dollarë për një mendim origjinal ose një aforizëm të mënçur. Në fjalimet para-elektorale nuk u gjënd asnjë mendim që të kush-tonte pesë dollarë. Që të nesërmen e debatit të dytë, midis kandidatëve rivalë për president, në shtyp u dukën tituj të tillë: «Lamtumirë debate të mëdha! Ju asnjë lexonjës nuk i shtoni gazetës sonë. Ngjashmëri e habitshme». Gazeta «Nju Jork Tajms» boton një karikaturë me këtë përmbajtje: Niksoni e Kenedi paraqiten në ekranin e televizionit. Vetëm disa sekonda përpara fillimit të diskutimit, Kenedi konstaton se e ka harruar fjalimin në shtëpi. Atëhere, ai i drejtohet kundërshtarit të tij, Niksonit, me këto fjalë: «Më jepni, ju lutem, gjysmën e fjalimit tuaj, që të fillojmë menjëherë nga debati».

Edhe sikur kjo shaka të vihej në jetë, askush nuk do të thoshte se ndonjëri prej kandidatëve ka shkarë nga vija e partisë së tij. Në të gjitha fushat, të dy palët nisen nga e njëjta pikë dhe synojnë të njëjtin objektiv. Ata ndahen për t'u bashkuar.

Ajo që quhet «mbështetësja» e kandidatit, gjithmonë mban të njëjtën vulë: «Dupon», «Melon», «Rokfeler». Kur Niksoni vuri kandidaturën Nelson

Rokfeleri filloi të dalë në publik, duke mbajtur në kokë një kapellë, ku ishte shkruar me gërma të mëdha emri i Riçard Niksonit.

Kenedi, nga ana e tij, ka «mbështetësen» e vet dhe, kur vjen puna për të krahasuar kandidatët, bie në sy po ajo ngjashmëri, siç ngjajnë dy kodra prej rëre. Të dy kandidatët janë si një palë këpucë: ato me të vërtetë janë të ndryshme, por njëkohësisht edhe të njëjta, — që të dyja kanë një numur, janë punuar nga i njëjti usta, plotësojnë njera tjetrën. Dhe e gjithë zhurma paraelektorale është zhurmë për të mbuluar ngjashmërinë, për të mbuluar identitetin e dy partive dhe kandidatëve të tyre përpara zgjedhësve.

Publicisti amerikan Norton, shkruan: «Disa njerëz, tek neve, mendojnë se zgjedhësi amerikan duhet të votojë duke patur parasysh pozitën politike të kandidatit për president. Zgjedhës të tillë zevzekë u shkruajnë letra redaksive të gazetave, shkojnë e trokasin nëpër dyert e senatorëve e kongresistëve, u bëjnë pyetje kandidatëve për president gjatë mbledhjeve të gjëra. Ata kërkojnë përgjigje për probleme të tilla: kur Shtetet e Bashkuara do të ndalojnë garën e armatimeve, çfarë do të bëjë qeveria për të zhdukur papunësinë? Sa njerëz naivë! Nga pyetje të tilla kandidatët për president largohen ashtu siç largohen edhe nga mizat e bezdisshme».

Kush paguan paratë, porosit muzikën

«— Xhentelmen! Është ora 4 e mëngjesit...

— ... dhe turi i 17 votimit.

— ... Prandaj sonte delegatët e Kongresit tonë duhet t'i japin fund qorr-sokakut e të zgjedhin, më në fund, midis gjeneralit të lavdishëm Simpkinson dhe shumë të respektuarit gubernator të shtetit Masaçusetc.

— Çfarë do të marrë Çarli Vebster, nëqoftëse do të përkrahë kandidatin tuaj për president, zoti Anderson? Postin e Ministrit?

— Ose ekuivalentin, i nderuari Vebster.

— Presidenti i ardhshëm do të aprovojë me siguri emërimin tim?

— Mjafton të më thoni mua dhe, edhe gjyshen tuaj ta emërojmë menjëherë ambasadore në Meksikë!»

Ky dialog është marrë nga komedia e shkrimtarëve amerikanë Xherom Llourenc dhe Robert Li, kushtuar zgjedhjeve presidenciale në Amerikë. Bisedimi zhvillohet në prapaskenat e njerit prej kongreseve të dy partive borgjeze të Amerikës (republikane apo demokrate, kjo s'ka rëndësi) ku mbretërit e qymyrit, naftës, automobilave dhe hekurudhave mbliidhen për të caktuar se cili do të jetë presidenti për katër vjetet e ardhshme.

Ja, komedia u çfaq në publik. Zgjedhjet mbaruan. Ethet e votave pushuan. Demokрати Kenedi fitoi. Republikani Nikson humbi. Reklamat para-elektorale, që bënë të gumëzhijnë veshët e çdo amerikan, tani duken si mbeturinat e një pazari të shpërndarë. Nëqoftëse dhjetë ditë më parë këta emra shërbenin si një ambalazhim tërheqës për mallrat e tregëtarëve, njeriu i rrugës as që pyet se kush u zgjodh, kush fitoi. Kjo i intereson atij,

sa edhe fati i biletës së grisur pas çfaqjes së një filmi të mërzitshëm.

Ndërsa «shtypin e lirë» vazhdon ta preokupojë problemi shumë i rëndësishëm në se Zhaklina, grua e Kenedit, do të marrë pjesë në konkurset e bukurisë, ashtu si dikur, apo vetëm do të kujdeset për të mirën e popullit amerikan, duke organizuar konferenca shtypi e duke shkruar artikuj mbi jetën e vet. Përsa i përket prognozës mbi politikën e jashtme, kjo, siç duket, u intereson më shumë disa gazetave të Evropës perëndimore. Shtypi amerikan është më realist në këto punë. Ai as që parashikon ndonjë ndryshim në politikë. «Nju jork Herald Tribjun» paralajmëron: «Ne besojmë se bota është mjaft e mënçur sa që ta dijë se kushdo që do të fitonte ditën e martë 1), nuk do t'i ndryshonte parimet dhe qëllimet e politikës sonë të jashtme».

Më në fund, organi «me tendencë republikane» tha një të vërtetë!

Kush është presidenti i ri? Rrethi familjar i Kenedit meriton vëmëndje. Ai ka një biografi të denjë për një post të lartë në udhëheqjen e imperializmit botëror. Në dinastinë e familjes Kenedi ka patur jo vetëm biznesmenë e kryetarë bashkije, por edhe kongresistë e diplomatë. Familja Kenedi ka patur gjithmonë «njerëzit e saj» në Uollstrit dhe jo vetëm në Uollstrit. Babai i Kenedit, duke qënë ambasador në Londër, para luftës së dytë botërore, e shtriu shumë rrethin e tij dhe krijoi një miqësi shumë të ngushtë me Hitlerin. Është e vër-

1) Zgjedhjet u bënë të martën, më 8 nëndor.

tetë se kjo miqësi dhe ky bashkëpunim me kancelarin e Rajhut i shkaktoi atij edhe disa telashe, por kjo nuk vazhdoi gjatë. Pas luftës u sqarua gjithçka: Xhozef Kenedi nuk kish bërë asnjë krim kundër imperializmit amerikan duke qënë mik i afërt i Hitlerit. Ai ish përpjekur që agresioni hitlerian të drejtohej kundër Bashkimit Sovjetik, prandaj keqkuptimet u kthyen në pluse. Djemtë e plakut milionerë fituan besim të madh tek forcat më të zeza të monopoleve amerikane. Vëllai i Xhonit, Roberti, u bë anëtar i komisionit famkeq të Makartit për ndjekjen e veprimtarive anti-amerikane.

Thuhet se Xhoni i beson shumë dollarit dhe aq më tepër u beson atyre që kanë shumë dollarë. Ky besim nuk ka lindur rastësisht: qysh kur ish fëmijë, i ati i dhuroi atij një milion dollarë njëherësh! Është e vërtetë se kjo nuk u ndie fare në buxhetin familjar, sepse ai numëronte disa qindra milionë, por në fatin e Xhonit milioni luajti një rol të madh; ai shërbeu si një trampolinë për ta ngritur atë deri në senat. Për atë u bë e qartë se njerëzit e shquar, siç janë për shëmbull senatorët, para së gjithash duhet të kenë para, dhe se të gjithë ata që kanë para janë të shquar.

Gjatë fushatës elektorale vëzhgonjësit vunë re se Kenedi, megjithse relativisht i ri, ka tendencë të gërmojë shumë në gërmadhat e ideve të kaluara, të qëllojë me fishekë të ndryshkur, duke mos iu shmangur, sidomos, edhe fjalorit të Xhon Foster Dallesit. Në një miting në Klivlend, brenda pesëmbëdhjetë minutave ai lexoi gjashtë citate nga burime historike, midis të cilave edhe një citat të

marrë nga fjalimet në dhomën e përfaqësonjësve të shtetit Kenektikut, në shekullin e XVIII-të!

Dorëzimi i stafetës

Maskarada arrin kulmin ditën e dorëzimit të stafetës.

«...Në fillim vjen një qerre që simbolizon besimin fetar, kambanat e së cilës bien me gjithë fuqinë, dhe që mban ikonat e shenjta... Qerrja vendoset në krye të kortezhit për të kënaqur presidentin... Një kauboj sillet lart e poshtë, duke vërtitur një lak nëpër duar. Ai kap në lak një polic të shërbimit të rendit. «Mami» (gruaja e Ajzenhauerit) e duartroket këtë gjest. I inkurajuar nga buzëqeshja e «mamit» kau-boji kërkon leje nga Presidenti që ta zërë edhe atë në lak. Ajzenhaueri ngrihet në këmbë, kau-boji triumfonjës vërtit litarin e tij, i cili mbështillet rreth qafës së presidentit. Fotografët e përjetësojnë këtë skenë... Mbi një qerre tjetër, 15 vajza të reja bëjnë poza të ndryshme me kostume banje, pavarësisht nga të ftohtit. Pastaj vjen «miss Amerika», edhe ajo e veshur me kostum banje... Më në fund, ja miss Burmah, elefanti — emblemë e partisë republikane. Entuziazmi arrin kulmin, kur Burmahu ndalon përpara presidentit dhe e përshëndet atë me kokë...»

Kjo ceremoni origjinale u zhvillua më 20 janar 1953, në Vashington. Republikani Ajzenhauer merrte stafetën nga demokrati Truman. Kjo ceremoni do të zhvillohet përsëri nesër 1). Kësaj radhe, de-

1) Më 20 Janar 1961.

mokrati Kenedi merr stafetën nga republikani Ajzenhauer. Ndryshimi është se i pari hyn në shtëpinë e Bardhë, i dyti del dhe se ceremonia do të mbyllet jo me përshëndetjen e elefantit, por me përshëndetjen e gomarit-emblemë e partisë demokratike. Të tjerat mbeten ashtu siç ishin: edhe rregullat e ceremonisë, edhe mënyrat e qeverimit, edhe inkubatori që «prodhon» ata që bëjnë politikën amerikane.

Tani, që presidenti i ardhshëm është gati për t'u kurorëzuar, agjentët zevzekë të gazetave të mëdha flasin për gjethet e rëna — Ajzenhauerin, Niksonin, Herterin.

I erdhi rasti të numërohen edhe lojnat e gol-fit, që ka zhvilluar presidenti; ndërsa kariera politike, siç duket, do të pasqyrohet më vonë në memuarët e Ajkut. Zakonisht, presidentët dhe kryeministrat perëndimorë fillojnë të thonë ndonjë fjalë të sigurtë vetëm kur dalin në pension. Prandaj duhet pritur që Ajku të shkruajë në të ardhmen për shumë gjëra: të tregojë se si, në kohën e tij, prestigji amerikan në botë u ngrit shumë lart... deri në nivelin e detit; se si nuk e pritën në Japoni (natyrisht, ky kapitull do të shkruhet sipas tregimeve të Hagertit, i cili në saje të çudirave të teknikës së sotme, mundi të shpëtojë në aerodromin e Tokios, duke u ngjitur në shkallët prej litari të një helikopteri); të tregojë se çfarë rezultatesh solli harxhimi i qindra milionë dollarëve për ndërhyrjen në Vietnam...

Shumë vëzhgonjës amerikanë përpigën të venë një kufi midis mbarimit të sundimit të Ajzenhauerit dhe ardhjes në fuqi të Kenedit. Një kufi në poli-

tikën amerikane, midis periudhës së sundimit të njerit dhe të tjetrit president, mund të vihet në atë shkallë sa mund të vihet një kufi midis dorëzonjësve të stafetës në pistën e stadiumit, ku vraponjësit sillen rreth, ecin në gjurmët e njeri tjetrit dhe që të gjithë synojnë tek i njejtë qëllim. Sinjali i nisjes jepet gjithmonë nga i njejtë gjyqtar: Uoll-striti.

Sidoqoftë, administrata e re ka një karakteristike të sajën: nga 10 ministra të emëruar në turin e parë, gjashtë janë avokatë. Kjo ka arsye të veta. Vetë qeveria e Kenedit është avokate mbrojtëse e monopoleve të mëdha dhe një gjë e tillë kërkon njerëz të përfeksionuar. Avokatët duhet të tregojnë se Rokfelerët nuk janë dhe aq të pasur sa thuhet dhe prandaj duhet t'iu ulen taksat; të tregojnë me fakte se punëtorët, e aq më tepër të papunët, mund të bëhen kapitalistë ose edhe mbretër automobilash, mjafton që ta dëshirojnë një gjë të tillë; të tregojnë se zezakve iu janë hapur të gjitha rrugët, bile edhe e drejta për t'u ulur në karrigen elektrike, që është shpikja më humanitare e Amerikës së sotme. Avokatët kanë pastaj detyra shumë të rëndësishme në fushën e politikës së jashtme, detyra që mund të përballohen vetëm me një vullnet shumë të fortë. Ata duhet të tregojnë ligjshmërinë dhe drejtësinë e doktrinës 120 vjeçare «Monro», ndaj atyre vendeve të Amerikës Latine që nuk duan të nënshtrohen; të tregojnë dhe bile të bindin botën se Çan Kai Shija nuk është vetëm një biletë votimi në xhepin e përfaqësuesit amerikan në organizatën e Kombeve të Bashkuara, po edhe simboli i botës perëndimore; ata duhet të tregojnë

cilësitë morale të Frankos dhe humanizmin e dashurinë për paqen të adenauerve dhe rëndësinë e madhe që ka për botën e lirë komunizmi nacionalo-specifik i Titos; ata duhet t'i venë bazë ligjore nevojës për të patur nën kontroll Vietnamin e Jugut dhe Laosin, si teritorë që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me mbrojtjen e integritetit tokësor të Amerikës, ashtu siç argumentoi Trumani në kohën e vet origjinën atlantike të Greqisë e Turqisë; ata duhet të tregojnë se nuk është e vërtetë se ndihma amerikane vepron si opiumi — sa më shumë që të marrësh, aq më tepër të dobëson.


Të gjitha këto do të jenë detyra të qeverisë së re.

Nëndor 1960 — Janar 1961

DINAMITI I MARKËS «UASHINGTON»

«... **D**ebatet në konferencën e çarmatimit ishin në kulmin e tyre. Mirëpo pikërisht në këto momente ndodhi një shpërthim i fortë, që hodhi në erë ndërtesën, bashkë me delegatët. Çfarë kish ndodhur? Në koridoret përpara sallës ku zhvilloheshin bisedimet, drejtori i një fabrike dinamiti po priste njërin nga delegatët e konferencës së çarmatimit për t'i propozuar një armë të re plasëse të fuqishme, të markës «Uashington». Duke nxjerrë shkrepjen nga xhepi, atij i shpëtoi nga duart modeli i armës së re dhe...»

Ku? Kur? Nuk e dimë nga është frymëzuar humoristi çek Hashek për krijimin e kësaj skene. Ndoshta nga e kaluara? Ka plotësisht mundësi. Historia e marrëdhënieve ndërkombëtare nuk njeh bisedime më të gjata, se sa bisedimet rreth problemit të çarmatimit. Filli i këtij lëmshi të ngatërruar shtrihet përtej kufive të periudhës së pas luftës së dytë botërore. Gjatë shumë vjetëve në Gjenevë u bënë disa qindra mbledhje për çarmatimin. Rezultati? Ashtu, si edhe skollistikët, që nuk mundën të zgjidhin problemin se kush ka lindur më parë, pula apo veza, ashtu edhe konferencat e Gjenevës




nuk kanë mundur të vendosin se kush vjen më parë, çarmatimi apo kontrolli.

Disa thonë se klima e Gjenevës vepron keq tek diplomatët, dhe se mbledhjet nuk duhen bërë në Pallatin e Kombeve, sepse ai është i mbushur me fantazmat e diplomacisë së dikurshme. Ndofta ata kanë të drejtë: në bibliotekën e Pallatit të Kombeve, në Gjenevë, gjenden dhjetra dhe ndoshta qindra volume të proces-verbaleve të mbledhjeve të përgjumura të Lidhjes së Kombeve, kushtuar çarmatimit. Tridhjetë e ca vjet më parë, në Gjenevë, asambleja e Lidhjes së Kombeve filloi përgatitjet për konferencën e çarmatimit. Por ndërsa përgatitjet e kësaj konference ecnin me hapat e kërmillit, veprimtaria për sabotimin e saj zhvillohej në mënyrë të ethshme. Para se të fillonin bisedimet për çarmatimin, po në Gjenevë, filloi punën mbledhja e tregëtarëve të armëve, ku rolin kryesor e luante Allen Dallesi, i njohur si babai i spiunazhit modern amerikan, dhe Herbert Huveri, që më vonë u bë president i Shteteve të Bashkuara. Disa nga përfaqësorët e qeverisë amerikane në Lidhjen e Kombeve kryenin, njëkohësisht, dy funksione: mbanin fjalime mbi rëndësinë e çarmatimit dhe, gjatë pushimeve midis dy mbledhjeve, merrnin pjesë në bisedimet e tregëtarëve të armëve. Në të njejtën kohë, në brigjet e bukura të liqenit të Gjenevës jehonte zëri i gërvishtur i lordit anglez Kashenden: «Çarmatim? Qesharake! Njeriu prej natyre është grindavec. Po t'i marrësh pushkën, ai kap thikën; po t'i marrësh thikën, ai kap shkopin; merrjani edhe shkopin, ai do të kacafytet me grushta».

Filozofia e lordit Kashenden, fillozofia sipas së

~~11/11/19~~

20454
BIBLIOTEKA E SHKENCËVE
DHE HISTORISKE



«Mbledhje dykatëshe»

cilës njeriu prej natyre është ujk, u shërbeu si ushqim kolegëve të tij në mbledhjet e bisedimet e pafund të Lidhjes së Kombeve. Ndërsa mbledhjet e Lidhjes së Kombeve vazhdonin rrugën e vet pa fund e pa krye, imperialistët amerikanë e englezë armatosnin me nxitim revanshizmin hitlerian dhe përgatitën luftën botërore. Më 1936, për herë të fundit, u shqyrtua problemi i çarmatimit. Rezoluta e Lidhjes së Kombeve tingëlloi si një notë qesharake e historisë. Rezoluta e aprovuar mbi këtë çështje nuk shërbeu më shumë se sa një epitaf mbi varrin e Lidhjes së Kombeve dhe njëkohësisht mbi varrin e lordit Kashenden, i cili vdiq pa i dëgjuar krismat e topave, por me besim se topat do të flisnin më në fund. Dhe folën! Nuk kaluan veçse tre vjet dhe u dëgjuan të shtënat e artillerisë së luftës së dytë botërore. Çadra e Çanberlenit nuk e mbrojti dot Anglinë nga bombat fluturuese «FAU-2».

Që atëhere ka rrjedhur shumë ujë. Kohët kanë ndryshuar në dëm të atyre që përbënin atmosferën e Lidhjes së Kombeve. E megjithatë zëri i urryer i lordit Kashenden vazhdon të dëgjohet në të gjitha mbledhjet për çarmatimin. Prandaj humoristi Haskok, ndofta ka patur parasysh edhe kohët e mëvonëshme, kur flet për dinamitin e markës «Uashington». Ka plotësisht të ngjarë.

Nga fillimi i vitit 1946 e deri afër fundit të vitit 1960, u bënë 1193 mbledhje për çarmatimin. Si rezultat, arsenalet mbushen me armë të reja, arkivat mbushen me dosje e protokolle të tjera. Maqinat llogaritëse moderne, përveç përlllogaritjeve të trajektoreve të sputnikëve artificialë të tokës, kanë bërë të mundur që lexonjësi i thjeshtë të njihet edhe me disa

kuriozitete statistikore rreth mbledhjeve të çarmatimit, të cilat, sikur të mos përdorej niveli i sotëm i teknikës së numërimit, do të qe e pamundur të zbuloheshin. Kështu, pra: gjatë 3579 orëve, të kaluara në mbledhje, delegatët perëndimorë folën 19 miliona fjalë mbi rëndësinë e çarmatimit. Kuptimi i tyre mund të përmblihet në katër fjalë: kontroll — po, çarmatim — jo! Vetëm delegati amerikan ka thënë 4 miliona e gjysmë fjalë. Kuriozët e statistikës kanë llogaritur se çdo fjale që ka thënë për çarmatimin delegati amerikan, i korespondojnë 100 miliona dollarë të harxhuara për armatimin! Protokollat e diskutimeve të delegatëve perëndimorë, në këto mbledhje, përbëjnë 95.440 faqe, dhe, sikur këto fjalë t'i hidhënim në një lentë teletajpi, do të duheshin 398 kilometra shirit. Asnjë artist cirku nuk do të kishte mundur të nxirrte nga goja një shirit kaqë të gjatë!

Të bisedosh me përfaqësonjësit e fuqive perëndimore është njëllë sikur të këndosh dueto me një shurdh. Le të lexojmë protokollin e punimeve të komitetit politik të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për çarmatimin, më 24 tetor 1960:

«Ora 10.30. Çekiçi i kryetarit të mbledhjes duhet të bjerë për fillimin e punës. Por as kryetari, as shumica e pjesëmarrësve nuk janë në vendin e tyre.

Ora 10.45. Delegatët, ashtu dalngadalë, ulen nëpër vendet e tyre. Kryetari i mbledhjes, zoti Korea, duket si i pavendosur dhe jo i qetë: ndoshta duhet pritur edhe ca? Minutat kalojnë... lëkundja e pasigurtë e kryetarit mori fund: disa anëtarë të delegacionit amerikan erdhën!

Ora 10.53. Çekiçi bën thirrje për qetësi. Kryetari thotë: «Mbledhjen e 1089-të të Komitetit të parë e deklaroj të hapur».

Në sallë akoma janë bosh vendet e 37 delegacioneve. Aty, këtu vijnë akoma njerëz, ulen pa kujdes, bëjnë zhurmë me letrat që kanë përpara.

Kryetari falënderon për besimin që i kanë dhënë dhe kërkon ndjesë që nuk mundi të falënderojë më përpara nga se e pengoi sëmundja. Ai falënderon zëvendës-kryetarin për drejtim të shkëlqyer gjatë mungesës së tij, falënderon pastaj pjesëmarrësit e mbledhjes për kontributin e frytshëm që kanë dhënë në hartimin e rendit të ditës.

Ora 11.06. Ngrihet oratori i parë. Ai i shpreh përgëzimet kryetarit, që u shërua kaqë shpejt.

Ora 11.15. Në portë duket figura imponante e Uodsvordit — kryetar i delegacionit amerikan. (Kjo është ngjarje që sigurisht meriton kujdes të veçantë, sepse ai është këtu udhëheqësi i «botës së lirë»).

Ora 11.54. Një orator tjetër bashkohet me urimet e përzemërta të parafolësit, në adresë të zotit Korea, i cili, për fatin e bardhë të të gjithëve, u shërua kaq shpejt.

Ora 12.50. Ngrihet oratori i tretë. Edhe ai, gjithashtu, thotë se është dakord me ato që thanë dy të parët.

Ora 13.16. Mbledhja mbyllet.

Disa delegatë nuk u dukën fare në mbledhjen e 1089-të të Komitetit të parë.

Si është puna? Gjithçka spjegohet me faktin

se në të gjitha mbledhjet për çarmatimin, ndën tavolinë, ndodhet dinamiti i markës «Uashington».

Megjithatë, ka njerëz që i varin shpresat për çarmatimin edhe në «bisedime» si këto. Ndryshe, mbledhje si këto as që do të ekzistonin.

Janar, 1961.

PAPAGALLËT

Të merresh me papagallët nuk është punë frytdhënëse. Po papagallët, për të cilët do të flas më poshtë, nuk janë papagallë të zakonshëm, banorë të kopshtit zoologjik. Ata janë një lloj tjetër papagallësh shumë të mençëm, që kanë cilësi jo vetëm të përsërisin ato që dëgjojnë nga ustai i tyre, po edhe të fantazojnë vetë, të lexojnë e të përsërisin edhe atë që nuk është thënë e shkruar asgjëkundi.

E kam fjalën për disa organe dhe agjenci bor-gjezo-revizioniste. Ky kor i gjërë papagallësh gjithmonë ka patur një repertor të dëndur kundër vendit tonë, por kohët e fundit, në këtë repertor janë futur numura të rij. Titujt e disa pjesëve të këtij repertori janë: «Në Shqipëri u shpall shtetrrrethimi»... «Pas orës 8 të mbrëmjes qarkullimi ndalohe»... «Në Shqipëri u vendos racionimi i ushqimeve».

Lista mund të zgjatet, po nuk është nevoja, se ne e kuptojmë ku e kanë hallin provokatorët, në Londër apo në Beograd. Ata kanë nevojë jo vetëm për sensacione. Atyre do t'iu pëlqente shumë sikur me të vërtetë të ndodhte ashtu siç trumbetojnë.

Këta zotërinj nuk janë as origjinalë dhe, sigurisht, as të fundit. Gjatë shumë vjetëve, ne i kemi dëgjuar teneqetë boshe të këtyre shpifësve të vajtueshëm dhe ua njohim të drejtën e stazhit në këtë profesion.

Ne po përgatitemi të kremtojmë festën e çlirimit të atdheut dhe të vendosjes së pushtetit popullor. Këto vite kanë qenë jo vetëm vitet e fitoreve tona, por edhe 17 vjet plot ethe e nerva për armiqtë tanë. Ata vazhdimisht kanë grumbulluar ushtrinë e vet kundër nesh e gjithmonë kjo ushtri është firaksur si kokrrat e fasules nga thesi i grisur. Këto agjenci e gazeta na kujtojnë një fletushkë të shekullit të kaluar, e cila kishte vënë si moto të saj këtë parullë: «Asnjëherë nuk duhet të gënjesh, me përjashtim të rastit, kur është e domoshme të bindësh të tjerët se ti thua të vërtetën». Të gjithë provokatorët kanë një karakteristikë të përbashkët, të gjithë ata veprojnë simbas rregullës së intrigantit, që thotë: «Për t'i shpëtuar dënimit dhe kritikave të të tjerëve, duhet të ngresh zërin, sidomos, kundër atyre fajeve dhe të metave që i ke vetë».

Papagallët shumë të mençur në redaksitë e gazetave reaksionare të Parisit, të Romës, Londrës apo Beogradit nuk dinë vetëm të flasin, por edhe të heshtin sipas komandës, nëqoftëse kjo heshtje i leverdis padronit, nëqoftëse kjo heshtje shërben si një perde e murme për të mbuluar të vërtetën, për të larguar vemendjen nga plagët e dhëmshme, që preokupojnë miliona njerëz. Faqet e shtypit shumë demokratik francez, kanë qenë të mbushura këto ditë, me thash e theme, rreth zhdukjes së

djalit të Rokfelerit në Xhunglat e Afrikës, ndërsa kur është fjala për fatin e mijëra patriotëve algjerianë, të cilëve qeveria e kolonialistëve francezë nuk iu siguron edhe qeli të zakonshme në burgjet e saj, «Frans Suar» e të tjera si ajo heshtin ose mezi shkruajnë ndonjë informacion, edhe ate të shtrembëruar. Gazetat e Parisit nuk i kursyen faqet e tyre për të përshkruar zjarrin që kish rënë në ndërtesat e Holli-Vudit, po kur është fjala për shpërthimin e bombave në shkallët e pallatit të Burbonëve, të vënë nga ultrat në bashkëpunim me policinë, atëhere papagallët mbyllin sytë dhe e fusin kokën ndën sjetull.

Shtypi krejt demokratik italian, i cili po iu qan hallin banorëve të kryeqytetit tonë, që jetokan në kushtet e «shtetrrëthimit», hesht për terrorin e përgjakshëm të policisë italiane kundër grevistëve. Dhe, kur është fjala për përshkrimet e shtëpive të fshehta të prostitucionit, ato zbukurohen me lirizëm të theksuar e me detaje aq të hollësishme, sa që gazetatat bëhen të rrezikshme për lexonjësin e padjallëzuar.

Disa kohë më parë, në një parlament perëndimor, u diskutua me pasion për mbrojtjen e bishtit të kuajve dhe veshëve të qenëve. Një vendim i posaçëm ndalon tani e tutje ndërhyrjen e pronarëve në tualetin e këtyre kafshëve shtëpiake. Si rrjedhim, nuk do të ketë më qen me veshë të prerë dhe kuaj me bisht të cinguar! Po kur vjen puna për fatin e puntorit, ate nuk e marrin në mbrojtje as parlamenti, as papagallët në faqet e fletushkave borgjeze. Policia angleze, duke zbatuar me përpikmëri ligjet shumë demokratike borgjeze, mbajti

për një kohë të gjatë, të mbërthyer në hekura, një papagall të dënuar nga gjyqi anglez, sepse kish guxuar të sulmonte pronaren e vet 75 vjeçare. Kjo shtrirje e demokracisë gjer në gjykimin e kafshëve, u përshkrua me shumë hollësi nga shtypi i Londrës, po, fakti që komunistët shpesh herë dënohen në bazë të një ligji të vitit 1365, as që bie në sy të shtypit të lirë.

Është kuptimplot fakti që, të gjithë tellallët e shtypit borgjez, që prej shumë kohësh, i kanë ngritur antenat e tyre në të njëjtën pikë: në Beograd. Prej kohësh propaganda reacionare borgjeze kundër vendit tonë, ka gjetur ushqim në strofkën revizioniste dhe kjo e fundit, nga ana e saj, është ushqyer me gjithfarë profkash, që thuren poshtë e lartë, kundër Shqipërisë. Dy enë komunikojëse, që mbushin e plotësojnë njera tjetrën.

Ne do t'ju thoshim këtyre zotërinjve të pa skrupull: Pa mendoni pak se sa qesharakë jeni bërë me shpifjet tuaja, në sytë e popullit shqiptar.

Mirëpo dikush mund të na përgjigjet:

— Si është e mundur? Papagalli nuk e ka koken për të menduar, mos i kërkoni papagallit gjëra të pamundura. Papagalli vetëm përsërit ato që i thotë ustai i tij.

Mirë, atëhere, le t'i drejtohem i ustait e t'i themi: shtatëmbëdhjetë vjet dështime janë një kohë mjaft e gjatë dhe që duhet marrë parasysh. Po, nëqoftëse ju ende nuk jeni lodhur, vazhdoni. Ne nuk kemi edhe aq shumë kohë që të meremi me juve!

Nëndor, 1961.

AHMETI DHE ZHANI

...Na ishte një herë një njeri me emrin Ahmet. Ai ishte dembel dhe asgjë nuk dëshironte të bënte. Për të gjitha fatkeqësitë e veta ai akuzonte Francën. Atëhere Ahmeti u bë kryengritës. Ai kujtonte se vetëm pushka do ta ushqejë dhe asgjë tjetër. Por, si rezultat ai ra në burg dhe vazhdon të dergjet atje...

Kjo përrallë nuk është rezultat i fantazisë së atyre që shtien fall në filxhanin e kafesë. Kjo është, me dy fjalë, përmbajtja e një broshure me titull «Paragjykimet çuan në kryengritje», të cilën e ka përhapur me bujë vite me rradhë «Shërbimi psikologjik i ushtrisë franceze» në Algjeri. Qëllimi i broshurës është modest: të bindë popullin algjerian se lufta e tij për çlirim është krejt pa kuptim, se as pushtimi kolonial, as uria e përbuzja, as burgjet e torturat — asgjë nuk ekziston. Të gjitha fajet i ka Ahmeti dembel...

Në vështrimin e parë duket qesharake që ndonjë njeri me mend në kokë t'u besojë përrallave të tilla. Por edhe marangozi fanatik, megjithse i bën vetë ikonat prej dërrase, a nuk ju falet atyre, duke bërë kryq kur iu kalon pranë? Pastaj, «shërbimi psikologjik» është shërbim psikologjik. Ai du-

het të kryejë detyrën e vet. Ahmeti duhet bindur të heqë dorë nga pushka se s'ka ç'i duhet; ushtari Zhan duhet bindur se ai nuk lufton për pushtimin e popujve të tjerë, por kundër dembelëve dhe për përhapjen e qytetërimit. Ndoshta kjo broshurë është shkruar më shumë për Zhanin se sa për Ahmetin. Përpara Zhanit duhej justifikuar fakti i njohur që, 17 vjet mbas luftës së dytë botërore, Franca vazhdon akoma të luftojë. Shtatëmbëdhjetë vjet pas luftës Franca nuk ka gëzuar akoma asnjë ditë paqe, për shkak se ajo nuk i ka pushuar për asnjë çast luftrat agresive: në fillim Indokina, më vonë Algjeria, pastaj Egjypti dhe përsëri Algjeria. Dhe të gjitha këto luftra kanë shërbyer si një inkubator për rritjen dhe nxitjen e elementeve fashiste, ato kanë qenë një zonë e helmuar për rininë franceze. «Ju jeni bijt e imperatorisë së madhe franceze që shtrihet nga Afrika veriore e gjer në Afrikën e Zezë, nga hapësirat e Azisë e gjer te ishujt e panumurt të deteve të hapur». Kështu na mësojnë në shkollë, thotë gazetari francez Marjan Lebesk. — Por, nëna ime, e mbetur jetime qysh në moshën dyvjeçare, dhe e rritur në një manastir nga disa murgesha bamirëse, me gjithse zotëronte Afrikën, e nxirrte bukën e gojës, duke larë dyshemetë. Babai im, pronar i Indokinës, e filloi dhe e mbaroi jetën e tij si punëtor i thjeshtë në një kombinat druri. Lavdia dhe fuqia e familjes sonë imperatorake arriti apogjenë ditën, kur ne arritëm të marrim me qira një copë të vogël toke në periferi të qytetit dhe ndërtuam atje një kasolle prej druri, e cila na nxinte të gjithëve... po të mos i shtrinim këmbët».

Kështu pra, nga njera anë Ahmeti dembel dhe i pa shpresë, nga ana tjetër Zhani — biri i imperatorisë së madhe.

Vitet rrodhën dhe «dembeli» Ahmet vërtetoi me fakte se ai nuk përton aspak, kur është fjala për të hapur varrin e zaptunjësve të tij; ndërsa Zhani, vëllai i të cilit i la kockat në Dien Bien Fu të Vietnamit disa vjet më parë, filloi të këndojë këngën e vjetër franceze: «Një kryq i vogël dhe një gropë e madhe — ja çfarë na pret neve». Këtë këngë të vajtushme e të ndaluar nga komanda, e këndonin ushtarët francezë në llogoret e Verdunit, në vitet e luftës së parë botërore. Tani ajo përsëritet në shkurret e Algjerisë nën diellin përvëlornjës... Zhani arriti kulmin e dëshpërimit. Tashmë ujetet e «shërbimit psikologjik» janë krejt të pamjaftueshme për ngritjen e moralit të tij.

Një proverb afrikan thotë: «Sado e gjatë të jetë nata, dita do të vijë». Nata algjeriane, me të vërtetë që shumë e gjatë, plot njëqind e tridhjetë e dy vjet! Tani që dita filloi të agojë (megjithse akoma diellin e pengojnë shumë re), duken ende më mirë sakrificat e panumërta që janë dashur për ta shkurtuar këtë natë të tmershme.


Si fillim i kryengritjes së armatosur algjeriane merret 1 nëndori i vitit 1954. Periudha e lindjes së shtetit të pavarur algjerian ishte shumë e dhëmshme. Dhe sikur të mos ishte ndërhyrja kirurgjike, shpata, ai kurrë nuk do të lindte. Prandaj, ajo çka u arrit nuk është rezultat i bisedimeve të gjata, por i luftës së gjatë e këmbëngulëse. Ajo që u arrit nuk është rezultat i marrëveshjes, por i detyrimit të kolonizatorëve nga ana e forcave revolucionare

kryengritëse. Historia e bisedimeve franko-algjeriane është historia e mosdashjes së kolonizatorëve për të biseduar, historia e manevrave dhelparake të kolonizatorëve.

... Qershor 1960. Bëhet takimi i parë zyrtar i përfaqësonjësve të Frontit Nacional-Çlirimtar Algjerian me përfaqësonjësit e qeverisë franceze. Vendi i takimit: qyteti i vogël francez Malen. Delegatët francezë ishin porositur në mënyrë të posaçme që të mos u jepnin as dorën algjerianëve. Këta të fundit u mbajtën një javë të mbyllur në një ndërtesë. Bisedimet nuk u zhvilluan.

Mars 1961. U duk sikur lëkundjet hamletiane të qeverisë franceze — «të bëjmë apo të mos bëjmë bisedime me qeverinë e përkohshme algjeriane» — muarën fund. Në ditët e para të prillit duhej të fillonin bisedimet në Evian. Bisedimet dështuan para se të fillonin. Kolonialistët kërkonin një Bao Dai algjerian, me qëllim që të bisedonin me «të gjithë» algjerianët, e jo vetëm me Frontin Nacional-Çlirimtar, kundër të cilit luftonte qeveria franceze. Kolonialistët nuk muarën përsipër as mbrojtjen fizike të përfaqësonjësve të Frontit Nacional-Çlirimtar Algjerian.

«Ora e bisedimeve është një orë e rrezikshme» — i paralajmëronte filozofi skeptik Monten gjeneralët e paaftë, të cilët mundoheshin të mbulonin dobësitë e tyre me mashtrimin, duke u përpjekur të gënjejnë kundërshtarin gjatë bisedimeve, për t'i diktuar pastaj atij vullnetin e tyre. Duke e ndjerë veten në pozitë të gjeneralëve të pa aftë për t'i dhënë fund me fitore, kolonialistët francezë kanë frikë edhe nga bisedimet, prandaj sillnin ndër-



KOLONIZATORI — Pse i bini të mirës me shkelm?

mend paralajmërimin e bashkatdhetarit të tyre se «ora e bisedimeve është e rrezikshme».

Ahmeti iu foli pushtonjësve në atë gjuhë, që e kuptojnë më mirë kolonizatorët! Dhe fitoi.

Ndërsa Zhani, që e kaloi rininë e vet në frontet e luftës në Algjeri dhe humbi vëllanë në xhunglat e Indokinës, vazhdon të pyesë: «Përse e gjithë kjo?»

Mars 1962

BUZËQESHJA E KUFOMAVE

Dikush mund të mendojë se shumë pak mbretër kanë mbetur në këtë botë, se selekcionimi i historisë është treguar i pamëshirshëm me ta dhe se vetëm kështu spieghohet fakti që dalja në dritë e çdo ekzemplari të kësaj «race», bie menjëherë në sy, bën sensacion e tërheq vemendjen, ashtu sikur të kalonte përmes pazarit një kafshë prehistorike.

Jo! Ne jemi në gjendje të vërtetojmë të kundërtën: në botë ka akoma aqë mbretër, saqë shekullit të sputnikëve i skuqet faqja. Në botë ka akoma aqë subjekte të kësaj race, saqë me ta mund të organizohen edhe panairë, që do të shkulinin së qeshuri edhe perënditë e Olimpinit...

Fakte? Urdhëroni: Panairin e Athinës! Por le t'i marrim gjërat sipas radhës.

Një ngjarje me rëndësi të përjetshme për fronet mbretërore të Greqisë e të Spanjës, pati vend këto ditë — martesë e trashëgimtarit spanjoll, Don Zhuan Karlos me Sofien, bijën e sovranit të Greqisë. Tani (Zoti e sjelltë mbarë) trashëgimtarë të tjerë do të lindin dhe... O, rëndësia e ngjarjes i kalon kufitë e dy vëndeve. Spanja e Greqia janë


dy «shtylla» të «botës së lirë», dy «modele të demokracisë» atlantike, dy miq (në asnjë mënyrë nuk duam të themi: dy satelitë) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndryshe nuk do të kishin urdhëruar të gjithë «ishet» e Evropës — edhe Mihai i Rumanisë, edhe Umbërto i Italisë, edhe mbretëresha Grac e Monakos, edhe Duka i Luksemburgut — plot 140 ish mbretër, princër e princesha të braktisura, regjente pa regjencë e trashëgimtarë pa fron... përfaqësonjës të njëzet e shtatë shtëpive mbretërore. Ndryshe, në Athinë nuk do të vraponin disa qindra korespondentë të «shtypit të lirë», disa dhjetra shoqëri televiziori e të filmave, të cilat morën përsipër barrën e rëndë për të mbajtur të informuar miliona njerëz (gjithashtu të «botës së lirë») rreth asaj çka po ndodhte në këto ditë të jashtëzakonshme në oborrin mbretëror grek, të tregonin se me çfarë entuziazmi e kënaqësie të madhe rrahin zemrat e popujve të Greqisë e të Spanjës në këto ditë historike... Çfarë lumturie!

Kush ka shkruar «Greva e demonstrata në Spanjë?» ose «Gjak e burgje në Athinë?» Propagandë komuniste! Shikoni çfarë pelegrinazh i shkëlqyer në kishën më të madhe të Athinës: në radhën e parë — mbretërit; në radhën e dytë dukët e princët: gjithsejt 148; në radhën e tretë vijnë anëtarët e qeverisë greke me në krye Karamanlisin dhe përfaqësonjësi personal i vetë Kaudilios spanjoll. Ku mund të bëhet një dasmë e tillë? Ku mund të ndodhë një mrekulli si kjo, veçse në një vend ku njerëzit janë mbytur gjer në grykë nga... liria! Dëgjoni çfarë solemniteti: kambanat e të gjitha kishave të Athinës rrahin pa pushim, plus qitjet e

artilërisë... O, këta tinguj janë në gjendje të mbytin çdo zhurmë demonstrate (kënaqësie) popullore! Kjo mund të ndodhi vetëm në një vend të lumtur...

Varfëri? Ku? Vështrojeni sofrën mbretërore! I mungon gjë? Vetë Frederika ka dhënë urdhër që kudo të shtrohen darka, dreka, mbrëmje vallëzimi për të përjetësuar dasmën e Sofies. Protestojnë se janë harxhuar 300.000 dollarë nga buxheti shtetëror, vetëm për një dasëm? Edhe po t'i ndajmë ato midis tre milion lypësve të Greqisë, nuk do t'ju binte të mirrin veçse 30 cent për kokë, ndërsa po t'i ndajmë midis të papunëve, një dollar për kokë u bie. E çfarë është një dollar për një të papunë? Kush nuk do t'ishte dakord t'i dhuronte princeshës Sofie një dollarë? Uri në fshatra? S'është e mundur kjo, në një vend ku vetëm bishti i fustanit të princeshës — nuse është shtatë metro i gjatë!

Kush ka thënë se pesëdhjetë mijë të rinj kanë kërkuar të ikin nga Greqia sepse nuk gjejnë punë? Lexoni shtypin e «lirë» dhe do të bindeni se në Greqi, përkundrazi, vijnë aqë shumë njerëz... Këto ditë vetëm nga Spanja erdhën gjashtë mijë krushq të princit — dhëndër, të cilët u pritën... e çfarë të flasim për këtë: gjithçka si në familjen mbretërore. Kujtoni pastaj se, vetëm në javët që shkuan, një kompani e tërë gjeneralësh e ministrash të paktit të Atlantikut erdhi, gjithashtu, në Athinë. Kujtoni se miqtë nga Gjermania Perëndimore, nga Shtetet e Bashkuara gjithmonë gjenden midis nesh, se ushtarët amerikanë, bazat, raketat... të gjithë vijnë në Greqi, dhe asnjëri nuk ikën prej këndeje... Ah, çfarë lumturie për popullin grek!



E morët vesh? Vetë princesha e Monakos ka ardhur në dasmë... Çfarë bukurie përrallore! Në shtyp ka lajme se tregtarët amerikanë bëjnë tregëti me fëmijët grek; se në 4300 shkolla gjashtë vjeçare ka vetëm nga një mësues! E pa mundur! Vështroni fishekzjarret, sa bukur shkëlqejnë. E dini sa e gjatë është princesha Sofie? Plot një metër e shtatëdhjetë centimetra! Po beli i saj? Këmbët?... Ja, këto janë temat.

(Të gjitha u matën me centimetra dhe u përshkruan me hollësi, prandaj në shtypin qeveritar nuk mbeti vend as për grevat e demonstratat e mëdha në Spanjë, as për kërkesat për dorëheqjen e qeverisë së paligjshme të Karamanlisit, as për lajmet mbi fatin tragjik të mijëra të burgosurve... Çdo gjë sipas rëndësisë!)

Ngandonjëherë historia duket sikur qëndron në vend. Lexoni këto rrjeshta të marruna nga një panflet i shkrojtur njëqind vjet më parë për një ballo të një «turme parazitësh me madhështi fallco, të zbetë, monstrooze, që ka humbur çdo personalitet, një turp për njerëzit, bile edhe për kafshët» dhe do të kujtoni se janë shkruar për panairin e Athinës... «Nëpërmjet tingujve të muzikës ndëgjohen klithma, fillon drama: Ujë! Ujë!... Vjen lajmi i tmershëm, muzika ndërpritet, fillon rrëmuja... Pse janë zverdhur gjithë këto fytyra?... Si, i nderuar zotri, paska në botë edhe diçka tjetër?... S'është e vërtetë! Gjithçka do të kalojë! Muzika! Bjeri më me forcë! Le të mbytin tingujt çdo gjë tjetër, çdo klithmë... Por ju nuk po dëgjoni, ju po dridheni, po ju mbulon një djersë e ftohët, po tmerroheni. Dhe me të vërtetë, ujët

po ngjitet lart e më lart, ju hapni dritaret, thërrisni për ndihmë, ju përgjigjet zhurma e shtërngatës, dhe dallgët e zbardhura, si tigra të tërbuar, përplasen mbi dritaret e ndriçuara! — Po, kjo është me të vërtetë e tmershme, edhe një minutë dhe rrobet elegante tërë shkëlqim të grave tuaja do të qullen! Edhe një minutë dhe stolitë krenare në gjoksin tuaj kanë për t'ju shtuar peshën dhe do t'ju tërheqin poshtë, t'ju mbytin. O, ç'tmer! ç'tmer».

Odejevski e ka quajtur panfletin e vet: «Për-qeshja e të vdekurit». Ne po i titullojmë këto rrjeshta: «Buzëqeshja e kufomave».

Maj, 1962.

TRE VETA NË NJË BARKË, DUKE LLOGARITUR QENIN

Shkrimtari englez, Xherom - Xheromi, pat shkruar një vepër humoristike me titull: «Tre veta në një barkë, pa llogaritur qenin», kushtuar një aventure gazmore nëpër lumin Temiz. Nëqoftëse dikush do të marrë mundimin të shkruajë, më vonë, për aventurën aspak gazmore të imperializmit amerikan në Vietnamin e Jugut, ka plot të ngjarë ta përdorë këtë titull të veprës së Xheromit, duke e ndryshuar pak a shumë në këtë mënyrë: «Tre veta në një barkë, duke llogaritur qenin», ku personazhet do të jenë: Maknamara, Ngo Din Diemi dhe... një qen i zakonshëm i ushtrisë amerikane.

Të kuptohemi. Unë nuk flas për qent në formë alegorike. E kam fjalën pikërisht për korpusin «K-9» të qenve të ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili është dislokuar në Vietnamin e Jugut, për t'u përdorur në luftën kundër partizanëve.

Ndofta rreth këtij korpusi nuk do të ishte folur fare në shtypin perëndimor, sikur të mos kishin lindur disa vështirësi që s'ishin parashikuar nga komanda amerikane. Në radhë të parë, siç duket, nuk janë marë parasysh aftësitë intelektuale

të qenve. Komanda ka vënë përpara kafshëve dy detyra të vështira:

E para, qent duhet të zotrojnë edhe një gjuhë të huaj, në qoftë se gjuhën angleze do ta marrim si gjuhën e tyre amtare. Agjencia amerikane «Asoshjeted Pres» shkruan: «Qentë që janë stërvitur t'i përgjigjen komandës vetëm në gjuhën amerikane, tani duhet të stërviten përsëri në gjuhën vietnameze; ose anasjelltas: ushtarët vietnamezë duhet të mësojnë gjuhën amerikane për të përdorur qentë». Pra: ose ushtarët e Ngo Din-diemit do të mësojnë gjuhën e qenve amerikanë, ose këta të fundit do të mësojnë gjuhën e ngo din-diemistëve. Meqënëse ushtarët e Ngo-së nuk qëndrojnë gjatë nën komandën amerikane (sepse dezertojnë) as që kanë mundësi që të mësojnë gjuhën angleze. Pra, gjithë shpresa duhet mbështetur tek aftësia linguistike e qenve.

Detyra e dytë (akoma më e vështirë), është që qentë, përveç nuhatjes së zakonshme prej qeni, duhet të kenë edhe nuhatje politike (!), sepse, për ndryshe — thotë «Asoshjeted Pres», — ata «kanë vështirësi për të bërë dallimin midis komunistëve dhe antikomunistëve».

Lexonjësi mund edhe të qeshë me pohimet e agjensisë amerikane të lajmeve, por fakti është se para disa ditësh, për në Vietnamin e Jugut, vrapoi vetë ministri i mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara, Maknamara, për zgjidhjen e këtyre problemeve të ndërlikuara të arësimit të qenve. Ne nuk e dimë me siguri se si e ka zgjidhur i deleguari i presidentit Kenedi këte çështje, por një gjë mund të thuhet që tani: gjuha e qenve amerikanë



— Mos, mos se është i yni.

në vendet e Azisë njihet shumë mirë; bile, jo vetëm gjuha, por edhe e kafshuara e qenve amerikane ju ka mësuar shumë gjëra fshatarëve vietnamezë. Është me vënd të kujtojmë këtu legjendën e Tunguo-së, e cila thotë:

«Në shtëpinë e filozofit Tunguo vajti një herë një ujk, të cilin barinjtë, pasi e kishin plagosur se u kishte ngrënë dhentë, po e ndiqnin nga pas.

— Ndihmë! — u lut ujku — Po më ndjekin njerëzit. Shpëtomë!

— Futuni këtu — tha Tunguo, duke i treguar ujkut një kafaz. — Meqënë se dukeni i penduar për atë që keni bërë, do t'ju shpëtoj.

Kaluan disa orë dhe bishën e mori uria. Tunguo e liroi ujkun nga kafazi, por ai nuk u largua nga shtëpia.

— Dua të ha — tha ujku — gjersa morët për sipër të më shpëtoni nga ndjekja e barinjve, atëhere duhet të më të shpëtoni edhe nga uria.

— Unë s'kam asgjë t'ju jap — u përgjegj Tunguo. — Nga vdekja ju shpëtova, tani shkoni e gjeni vetë ushqim.

— Jo! — tha ujku, duke iu kërcënuar. — Unë do të të ha ty!

Tunguo gjithë jetën e kish kaluar duke lexuar libra për shkencat më të ndryshme, por në as një vënd ai nuk kish lexuar se si duhet të sillesh me ujkun. Prandaj ai u fut në një bisedim të gjatë filozofik me bishën. Cili prej tyre kish të drejtë? Ujku apo Tunguo?

Merret me mënd se si do të kishte përfunduar ky dialog, sikur në këtë çast të mos kish ardhur një fshatar, i cili megjithëse nuk kishte lexuar asnjë

libër, filozofinë e ujqërve e dinte shumë mirë. Pasi mori vesh thelbin e konfliktit, fshatari tha:

— Grindjen mund ta zgjidh unë. Por, që të mund të marr një vendim të drejtë, është e nevojshme që secila palë të qëndrojë në pozitë fillestare: ujku të futet përsëri në kafazin ku ishte mbyllur, ndërsa Tunguo të ulet në tryezën e tij, me librat përpara.

Ashtu u bë... Fshatari mori kafazin me ujkun brenda dhe... e hodhi nga maja e një shkëmbi.

Çfarë zgjidhje e thjeshtë! Praktika e jetës e kish mësuar fshatarin si të silllet me ujkun.

Sot, nëqoftëse amerikanët dhe kukullat e tyre në pjesën Jugore të Vietnamit, në xhunglat e Laosit apo në Tailandë, jetojnë të rrethuar prej korpuseve të qenve, kjo nuk është veçse rezultat i faktit që, në këtë pjesë të botës tani nuk është në modë filozofia e Tunguo-së. Po, ka ikur ajo kohë!

Presidenti Kenedi ndërsen qent kundër popujve të botës. Është e natyrshme, pra, që popujt, nga ana e tyre, të ngrenë shkopin.

Barka me një ekuipazh të tillë nuk udhëton dot gjatë.

Qershor 1962.

PËRQAFIMET E SPRUTIT 1)

Njeri nga mbretërit e Francës, Françisku i I-rë, kur po luftonte kundër kumbarës së vet, Karlit të V-të, imperator i imperatorisë së Shenjtë të Romës, për të fut në dorë tokat romake, pat shkruar: «Unë dhe kumbarja im i dashur, jemi plotësisht të një mendimi — që të dy duam të pushojmë Milanon».

Pra ekziston edhe një «unitet» i tillë mendimi e veprimi. Dhe ai është karakteristikë jo vetëm për monarkët e shekullit të XVI-të, por edhe për pasardhësit e tyre në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të. Për shembulla nuk na duhet të shkojmë larg.

Kancelari i Gjermanisë Perëndimore, Adenaueri, bëri vizitën e tij të 15-të në Francë. Gjatë gjithë këtyre ditëve shtypi borgjez i Parisit ka qenë i mbushur plot me fjalime e komente, në të cilat duket se është shkruar gjithë aftësia oratorike dhe janë derdhur të gjitha lotët e gëzimit për të treguar miqësinë tradicionale midis Francës e Gjermanisë,

1) Shumëkëmbësh, kafshë deti grabitqare.

për të treguar se ditë të bardha paskan ardhur, se militaristët e Gjermanisë perëndimore janë bërë tashmë miqtë më të ngushtë të Francës, se e kaluara midis këtyre dy vendeve nuk është veçse një keqkuptim që nuk meriton asnjë vemendje!

Si pika kulminante e solidaritetit gjermano-francez u zgjodh dita e fundit e vizitës së kancelarit të Bonit. Në kampin ushtarak të Murmelonit, ku janë vendosur trupat e Bundesverit, u zhvillua parada ushtarake e trupave franceze dhe gjermano-perëndimore. (Përsëri ushtarëve të Gjermanisë perëndimore nuk ju mjafton «hapësira jetike» për të zhvilluar paradat në tokën e tyre). Pas paradës kancelari mori pjesë në një meshë solemne në katedralin e Reimsit, ku janë pagëzuar të gjithë monarkët e Francës. Sfondi i kësaj meshe që me të vërtetë prekës. Muret e katedrales së Reimsit ruajnë ende plagët e bombardimeve gjermane gjatë luftës së kaluar. Prania e disa dhjetra gjeneralëve gjermanë në këtë meshë e plotësuan kuadrin e dikurshëm. «Kthimi i djalit plangprishës — thotë agjencia franceze e lajmeve — është diçka më shumë se një bashkim familjeje». Tani djali plang-prishës mori pagëzimin dhe ka mundësi që, me ndihmën e zotit që i ka shtrirë krahët e veta nga të dy anët e Atlantikut, të bëhet djalë i urtë.

Historia, para së gjithash, është fakte. Filozofi Monten thoshte se «nëqoftëse njeriu nuk i beson kujtesës së tij, ai nuk duhet t'i largohet së vërtetës». Çfarë tregon e vërteta? Franca është pushtuar tri herë nga çizmja gjermane, gjatë një brezi njerzish. Nuk është pak kjo. Një proverb thotë: «Nëqoftëse më gënjen një herë, — je fajtor ti, nëqoftëse më

gënjen për të dytën herë — jam fajtor vetë». Franca është mashtruar e pushtuar nga imperia-
lizmi gjerman jo një ose dy herë, por tri herë.


Mos vallë në pallatin e Burbonëve banojnë edhe sot daladjerët?

Tetëmbëdhjetë vjet më parë, duke folur me rastin e çlirimit të Parisit nga okupacioni hitlerian, gjenerali De Gol tha se Franca kthehet në kryeqytet e larë me gjak, por ajo ka marrë njëkohësisht një mësim të mirë nga një provë e rëndë. Nuk kaluan as dy dekada dhe, ndërsa këto fjalë u harruan, militaristët e Gjermanisë Perëndimore, të organizuar e armatosur nga imperializmi amerikan, nuk e harruan zakonin e tyre. Në rrugët e qyteteve të Francës ndëgjohen fërshëllimat e aeroplanëve me kryq të zi. Pa harxhuar asnjë fyshek, oficerët hitlerianë mund të heqin (në emër të unitetit) nga kinematë e qyteteve franceze filmat që nuk ju pëlqejnë.

Në krushqitë franko-gjermane secila palë bën llogaritë e veta, sa të thjeshta aq edhe të ndërlikuara. Borgjezia e lartë franceze mendon ta përdorë solidaritetin me Adenauerin, për presion kundër aleatëve të tjerë të NATO-s, sidomos kundër pozitës së Anglisë në kontinent, me qëllim që të zërë vendin më të rëndësishëm në Evropën perëndimore. Militaristët e Gjermanisë perëndimore, nga ana e tyre, i përdorin përqafimet me Parisin për të patur krahët e sigurta në aventurat drejt lindjes, për të fut në dorë armët atomike përmes Francës, për ta përdorur Francën si bazë për stërvitjen e reparteve të Bundesverit, ose «për të genë atje», sido që të ndodhë.

Me një fjalë, të dy palët janë plotësisht të një mendimi në synimet për të «pushtuar Milanon». Por kush mund të fitojë në këte mes? Është e qartë se përqafimet e militaristëve gjermanë janë, për francezët, ashtu si përqafimet e sprutit, i cili, gjithashtu, përpara se ta gllabërojë viktimën, e «përqafon»...

Ka qenë një kohë kur aleancat agresive të shteteve imperialiste të Evropës i quanin me emrin përkëdhelës: «Koncerti i shteteve evropiane», megjithse kur vinte fundi, anëtarët e kësaj orkestre, thyenin veglat në kokën e njeri tjetrit. Edhe në ditët tona dikush e ka krahasuar tregun e përbashkët, (këtë «Evropë të atdheve») me një orkestër ku rolet janë ndarë në këtë mënyrë: Pjanofortia — bie në Paris, violina e parë — në Bon, oboe — në Romë, kornet — në Bruksel, kontrabasi — në Amsterdam. Përsa i përket harmonisë, secili i bie sipas notave të veta!



Përqaqimet e sprutit

Ku është dirigjenti? Për këtë vend paraqiten, të paktën, tre kandidatë. Natyrisht kjo nuk spiegotet me papunësinë kronike në vendet kapitaliste, por me dëshirën për t'i diktuar dhe për ta shpartalluar partnerin. Për këtë post pretendon Parisi. Pretendon dhe Boni, i cili, duke trashëguar gjithë bagazhin e revanshizmit gjerman, kërkon akoma të zbatojë parullën: «më jepni atë që kërkoj, ose do ta marr vetë!». Pretendon, sigurisht, Londra, e cila, megjithse po jeton mundimet e dështimit (bën të hyjë e nuk hyn dot në kornizën e «tregut të përbashkët»), prap se prap nuk dëshëron të lëshojë «vendin e luanit» në gjysmë-skenën e Evropës.

Në këtë situatë, politikën e secilit nga prete-nduesit për zotrim në Evropën përfundimtare (si kompesim për humbjet në kontinentet e tjera) mund ta krahasosh me psikologjinë e një artisteje të plakur prej kohësh, por që nuk pranon të njohë moshën e vet dhe akoma pretendon se është në gjendje të luajë rolin e Borëbardhës.

Korrik, 1962.

MJERGULLA E LONDRËS

Thuhet se për Londrën, njerëzit dhe mjergullën e sajë, janë shkruar mijëra libra. Vetëm katalogu me titujt e këtyre veprave, i cili ruhet në muzeun britanik, përbëhet prej disa volumeve. E megjithatë tani në Londër kërkohen urgjentisht Gogolë, Çehovë ose të paktën Mark Tveni për t'i shtuar historisë së Londrës volume të reja. Tema është shumë prekse e me variacione. Autori është i lirë të zgjedhë titullin që dëshiron për veprën e tij. Mund ta quajë atë thjeshtë: «Skandali Profumo». Po qe se ky titull i duket se e thjeshtëson shumë temën, atëhere mund ta quajë: «Anglia zbuloi vetëveten». Po qe se dëshiron diçka më poetike, mund ta titullojë: «Tek burimi i parlamentarizmit dhe demokracisë borgjeze». Po autori le të zgjedhë si të dëshirojë. Një gjë është e garantuar: në të gjitha rastet materiali nuk do t'i mungojë.

Ne po mundohemi të rëndisim këtu poshtë disa nga faktet, me qëllim që autori ose autorët e ardhshëm ta kenë më të lehtë punën e tyre. Shënojmë që në fillim se do të jemi më të paanshëm se sa lordi Dening, i cili, megjithse botoi një libër të tërë në formën e raportit zyrtar rreth «çështjes

Profumo», na duket se ka humbur më shumë kohë dhe bojë për të hedhur hie mbi skandalet, se sa për t'i zbuluar ato përpara publikut.

...Nga një herë flet më shumë një i vdekur se sa disa dhjetra të gjallë. Njeri nga pjesëmarrësit e ngjarjes që mori emrin e Profumos, është doktor Uordi, i cili, në kushte të pa sqaruara mirë, vdiq në burg, para se të dilte në gjyq. Është e qartë se Uordi vdiq që të mos fliste, mirëpo lindi pyetja: kush interesohet për heshtjen? Siç duket Uordi dinte më shumë se sa duhej të dinte rreth asaj që ndodh në prapaskenën e shoqërisë së lartë engleze. Dhe kjo u bë fatale për të.

Si njeriu që humbi më shumë në këtë histori, për Uordin meriton të themi disa fjalë, që në fillim.


Si osteopat që ishte, Uordi dinte më mirë se kushdo tjetër në këtë botë të fërkojë shpinat, bile më me mjeshtri se Xherri Fini në librin «Rruaza e katërt». Klientela e tij ishte për t'ja patur zili të gjithë kolegët — ajo fillonte që nga yjet e kinemasë me Sofia Lorenin e mbaronte me Çërçillin, Nehrunë e Harrimanin, të cilët, gjithashtu, po tek doktor Uordi i kanë reparuar kurrizet e tyre të kalçifikuara. Uordi, si briland i shoqërisë së lartë, ishte një magnet i vërtetë për femrat, të cilat dinë t'i çmojnë dhe t'i kthejnë në flori karakteristikat tërheqëse të trupit të tyre. Zemra e Uordit kishte një volum të jashtëzakonshëm. Gjatë jetës sime, ka thënë ai, kam dashuruar qindra vajza, por ç'e do, në rrugën e dashurisë ka pengesa të mëdha. «Ligjet tona të rrepta të moralit mbytin ndjenjat e natyrëshme të njeriut». Por se sa të rrepta janë ligjet morale të shoqërisë së lartë të Anglisë së

sotme, mund të gjykojmë nga këto citate të nxjerra nga memuarët e Uordit, të botuara në një revistë të Gjermanisë Perëndimore: «Mua më patën ftuar në një mbrëmje në Hempsted. Pamja e njerëzve lakuriq në të gjitha qoshet e dhomave, në fillim, më krijoi një farë përshtypjeje të keqe, por, si çdo pemë e ndaluar, zgjoi edhe kureshtjen time. Në kohën kur unë vështroja në të katër anët si i ndrydhur, mu afrua një burrë dhe më tha: «Në-qoftëse iu duket e çuditshme kjo skenë, atëhere urdhëroni tek unë në mbrëmje, ku, me të vërtetë do të habiteni». Shkova edhe atje. Mbrëmja kish qënë e organizuar me të vërtetë nga njerëzit më të denjë që jetojnë në Çells. I zoti i shtëpisë më kish porositur të vishesha me frak. I vetmi kusht që iu vihej vizitorëve ishte që ata, çfardo që të shihnin, të mos shprehnin habinë... Kur unë u paraqita në orën e caktuar, më doli përpara zonja e shtëpisë. E gjithë veshja e saj përbëhej nga një kapele e madhe me rreth, nga çorape të zeza të mëndafshta dhe këpucë me taka të larta... Ajo bënte pjesë në radhën e grave më tërheqëse të Londrës. Kjo nuk qe e vetmja surprizë. Pak më vonë, kur u ulëm rreth tavolinës të mbushur me të gjitha të mirat dhe zonja e shtëpisë e veshur në një mënyrë kaq të jashtëzakonshme na bëri shenjë të fillonim të hanim, hyri Kelneri, në trupin e të cilit ishte vetëm një shall bojë rozë i lidhur për qafe dhe një maskë gome me vrima të vogla për sytë dhe gojën... Mbrëmja zgjati disa ditë e net pa ndërprerje. Ne pinim verë të përzier me disa medikamente kundër gjumit. Të gjithëve na ishin mbaruar forcat. Na u desht të thërrisnim

përsëri vajza, por dorza e telefonit kishte rënë në dysheme dhe asnjëri prej nesh nuk qe në gjëndje ta gjente e ta vinte në vënd. Atëhere, i zoti i shtëpisë mblodhi të gjitha forcat dhe shkroi këto fjalë në një copë letër për kujdestarin e shtëpisë që rrinte tek porta e jashtme: «Kini mirësinë e telefononi në numrin...» Dikush e hodhi letrën nga dritarja. Për fat të keq ajo ra jo tek portieri, por në kapelen e një dame që kalonte aty pranë, e cila, pasi e lexoi, telefonoi menjëherë në polici, duke kujtuar se dikush ka nevojë për ndihmë urgjente. Brenda disa minutave ra zilja e portës. Një vajzë me kostumin e Evës shkoi e hapi derën. Kur pa dy burra, ajo tha: «Jo, neve nuk na duhen burra, vetëm vajza». Dhe e mbylli derën. Dedektivët, të habitur, trokitën përsëri. Tani portën ua hapi Adami...»

Çfarë ndodhi më tej?

Policia e lart-madhërisë së saj është më shumë mbulonjëse se sa zbulonjëse e krimit. Siç e spiegon edhe vetë Uordi «e drejta engleze nuk i ndalon gjërat e tilla», prandaj asgjë nuk ndodhi edhe pas këtij kontakti «sy ndër sy» me policinë. A mund t'i ndalohet ministrit të luftës të Anglisë të vishet me kostumin që dëshëron, duke përfshirë edhe kostumin e Adamit? Pastaj, duhet marrë parasysh se ku shtrohen këto mbrëmje origjinale... Nja dyzet kilometra larg Londrës gjëndet pallati madhështor Kliveden, pronë e lordit Astor, gjithashtu njëri nga figurat qëndrore të çështjes Profumo. Në historinë engleze ky pallat shënohet si vendi ku u ekzekutua hymni kombëtar, për herë të parë, dhe ku ruhen ngjarjet e së kaluarës së



Në hien e Pentagonit

largët. Englezët që e vizitojnë tani atë do të kenë mundësinë të mësojnë jo vetëm se si Duka i Bermingamit, tre shekuj më parë, vrau në duel rivalin e tij kontin Shrevsbyru, por edhe se si në një mbrëmje qershori të vitit 1961, ministri i tyre i luftës, 48 vjeçari Xhon Profumo bëri takimin e parë me ish kamarieren gjermane Kristinë Keler, që me bukurinë e saj kish vënë në lëvizje e në konkurrencë shumë lordë e personalitete të rangjeve të ndryshme.

Xhon Profumo, dikur anëtari më i ri i dhomës së komuneve, qe një shpresë e madhe për Torët (konservatorët). Ai, e filloi kariërën e vet me fjalime tërheqëse. Biografët e Profumos theksojnë se fraza më e preferuar e ministrit ishte: «Shteti është shërbyesi i popullit dhe jo tiran». Kjo frazë nuk e ndaloi atë t'i shumëzoi milionat e stërlinave që i la i ati — baron dhe të krijojë një rjet ndërkombëtar prostitutash. Këto janë dy detyra të denja për një ministër të Anglisë së ditëve tona. Përsa u përket çështjeve ushtarake, për ato le të mendojë më mirë Pentagoni. Pentagoni le të vendosi në se Anglisë i shkon më mirë raketa «Skajbol» apo ndonjë tjetër, anijet e nënujëshme apo të mbiujëshme, sa dhe çfarë lloj bazash ushtarake amerikane mund të vendosen në tokën engleze... Për ish «mbretëreshën e detrave», për ish perandorinë ku nuk përdante dielli, është më e rëndësishme tani të merret me historitë e aventurave të Kristina Kelerit, e cila, pa mbushur të 22 vjetët, arriti të jetë protagonistja e tre gjyqeve publike.

Një profesor i Kembrixhit ka shkruar: «Kjo ngjarje më detyron të bëhem shovinist: unë them se tani me të vërtetë jemi të denjë për të bërë pjesë në komunitetin evropian».

Më qartë s'ka ku të shkojë.

Korrik 1963.

SHQETËSIMET I XHEK PATERSONIT


— Monolog —

Unë e them hapur: jam i zemëruar! Arësyeja? Çdo gjë ka ndryshuar për keq: as bota nuk është ajo që ishte vite më parë, as dollarët (pashaporta jonë) nuk janë ato që ishin dikur... Për këtë jam i bindur tashmë nga eksperiencia ime. Gjatë shumë viteve, me cilësinë e biznesmenit amerikan, kam shëtitur vende të ndryshme të globit tokësor dhe jam në gjëndje të bëj krahasimet e mia. Është e vërtetë se mua më ka interesuar më shumë barometri i bursës se sa barometri i politikës, por kjo nuk më ndalon të them se ne amerikanët kemi përse të vajtojmë të kaluarën, kemi arsye të mos kënaqemi me të tashmen, kemi përse të shqetësohemi për të ardhmen. Nuk është nevoja të kesh zgjuarësinë e Shorllok Hollmësit për të parë atë çka po ndodh rreth nesh. Erdhi koha kur ne duhet të themi: «Eh, vite të arta! Ktheuni përsëri». Po, po: «ktheuni», sepse ata tashmë kanë shkuar. Ç'është e vërteta na kanë dalë edhe miq të rinj, madje nga s'e prisnim, dhe sikur po na japin një çikë zemër, por mua më pëlqen të jem realist e

nuk ju besoj fantazmave, ata e kanë vështirë për vete, jo më të na shpëtojnë neve...

Jo shumë kohë përpara ne ishim xhaxhai i pasur midis aleatëve tanë. Edhe kur futnim dorën në gji për t'u kruar, ata hapnin sytë me shpresë se ne do t'iu falnim diçka. Unë nuk po flas këtu vetëm për Greqinë, Turqinë, apo Italinë. Po të dëshironi, le të marrim Francën. Përfytyroni pasluftën: shkoje për në Francë dhe kërkush nuk i fuste hundët në valixhet e tua. «USA? Kaloni!» Ne ecnim nëpër rrugët e Parisit dhe na dukeshin si rrugët tona. Aty pranë kalonin vajza të veshura bukur e plot naze, ndërsa ne e dinim se ato zonjushe të bukura, që të gjitha, nuk janë tjetër veçse lypës që kanë shtrirë dorën. Dhe drejt kujt? Pikërisht drejt nesh.

Sa mirë të jesh i pasur! Ja ç'më ndodhi një herë. Në mos gabohem, ishte viti 1948. Desha të takoj mikun tim, që ishte administrator i planit Marshall në Paris. I shkova në zyrë. Dhoma e pritjes ishte plot me njerëz, ashtu si në ndonjë ambulancë. Në një qoshe ish strukur një plak dhe dukej se po e torturonte dhëmballa. Pasi priti nja pesëdhjetë minuta, i erdhi radha të hynte. E dini kush ishte? Ramadje, kryeministri i Francës. Sa mirë! Po tani? Dikush u gëzua kur ajo na i pagoi të gjitha borxhet e luftës, para afatit. Kurse mua kjo më hidhëroi pa masë... Si? Unë nuk jam patriot i vëndit tim?! Gaboheni. Po ju pyes: si është më mirë — të të kenë apo, të mos të të kenë borxhe? Unë them se është më mirë kur njerëzit janë borxhllinj ndaj teje; atëherë ke autoritet, të respektojnë, fjala jote ze vënd, urdhërat e tua janë gjithmonë të drejta, të zbatueshme.



— As bota nuk është ajo që ishte!

Po. Franca (dhe jo vetëm Franca) na detyrohet shumë. Gjithë Europa na detyrohet! Gjithë bota! Atë çka bëjmë ne për botën zor se e bëjnë të tjerët për ne. Le të marrim vetëm një shëmbëll. Ne i kemi shpërndarë bijtë tanë në të katër anët e planetit. Katërqind mijë ja kemi dërguar vetëm Evropës. Pse, punë e lehtë është të ndahesh nga bijtë e tu? Detyra! Kujdesi për të tjerët! Mos vallë për të mbrojtur tokën amtare vriten bijtë tanë në shkurret e Azisë e Afrikës? Jo vetëm bijtë por edhe qentë tanë i kemi çuar për të mbrojtur rendin e lirisë në Vietnam. Ah, Vietnami! Cili shtet tjetër do të bënte për këtë vend të mallkuar aq sa bëjmë ne! Pastaj, kujtoni ju se ne nuk na duhen qentë në shtëpinë tonë? Ju a them unë: i kemi hequr nga vetja jonë. Shikoni se çfarë vështirësish heq policia jonë me zezakët. Po të kishte më shumë qen, më lehtë do ta kishte. Po, ne bëjmë sakrificat tona. Na e dinë për nder? Hiç! Edhe shpenzimet për mbajtjen e ushtarëve tanë nuk duan t'i paguajnë. «Jemi të varfër» thonë. Ah, e di unë e di, se çfarë duan ata.

Ca kohë më parë Harrimani ynë trokiti në të gjitha portat e aleatëve evropianë. Me fjalë të mira e pritën; por sa para bën? Fundi ka rëndësi. Asnjë grosh nuk i dhanë. Çfarë aleatësh! Mua më duket se ne e shtërnuam aqë shumë Evropën në krahët tona, saqë u lodhëm vetë! Tani ata tallen me ne. Bile protestojnë. Mjafton që një ushtari ynë (helbete, njeri larg shtëpisë) të shkelë qoftë edhe një udhëtar të rastit me automobil, ose t'i thotë diçka ndonjë vajze, dhe menjëherë bëhet zhurmë. Lere, po edhe turqit kanë filluar të pro-

testojnë: «Ju amerikanët...» e ku ta di unë. Kësaj i thonë bëj mirë e gjej keq. Madje unë kam përshtypjen se duan edhe të na përqeshin. Para ca kohe, kur isha në Paris, një i njohur më tha: «Përfito nga rasti e blej Pikason e Rembrandin, se kanë dalë komplet». Unë i thash se në Amerikë zor se do të gjënden pjesë këmbimi për ta. Bashkëbisedonjësi im ja plasi gazit sikur ta kisha prekur ndënë sqetull. «Si? në Amerikë s'ka pjesë këmbimi për Pikason e Rembrandin?!» Mua më hypi gjaku në kokë. Në fund të fundit, ç'ka këtu për të qeshur? Pikaso e Rembrandi nuk qënkan fshirëse, por... ku ta di unë? Qofshin me shëndet. Ç'ka këtu për të qeshur? Unë po të dua i blej të gjithë Pikasot tuaj dhe nuk le asnjë për be. Mirëpo bashkëbisedonjësi im as donte t'ja dinte: vazhdonte të qeshte si pa të keq. U detyrova të largohem pa u përshëndetur me të. Hë! Sikur kjo të ndodhte disa vjet më parë, ai nuk do të qeshte me mua. Përkundrazi, do të priste me respekt të madh çdo fjalë timen. Ah, kohë, kohë, si keni ndryshuar!

Por, se mos vetëm në Evropë dhe në Azi. Njerëzit janë bërë të pandreqshëm edhe në shtëpinë tonë — në Amerikën Latine. (Unë nuk e kuptoj pse ajo quhet Latine, por neise, le ta zgjidhin historianët këtë çështje, rëndësi ka që ajo të jetë e jona). Nuk dua të fyej njeri. Xhentilecën e kemi në gjak ne amerikanët. Por ama nuk mund të rri pa thënë, me keqardhjen më të madhe, se miqtë tanë, edhe në këtë pjesë të botës, e kanë humbur shkëlqimin e dikurshëm; ata mundohen të na buzëqeshin, por mua më duket se kjo është buzëqeshje kufomash, të cilat, vetëm për çudi nuk janë

varrosur ende. Ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse thithin oksigjen nga bombolat tona. Provoje t'ua presësh oksigjenin dhe ata... si Ngo Din Diemi. Po, po, ndofta edhe më keq: të paktën ai e zgjodhi rrugëdaljen me dorën e vet. Edhe kjo një privilegj është...

E habitëshme dhe e pa spjegueshme është se si edhe në disa qoshe të humbura të botës kanë filluar të na shikojnë shtrembër, bile më keq se shtrembër.

Unë akoma jetoj nën përshtypjen e tmershme të një ngjarjeje të vogël, që ndodhi me mua vitin e kaluar, kur vizitova si turist Brazilin. Vendosa të shkoja në shtetin më të prapambetur të këtij vëndi, ku, përveç ekzotikës, do të shikoja se deri ku ka shkelur lavdia jonë, dhe ç'shkallë ka arritur mirënjohja popullore ndaj nesh. Puna e parë: — hyra në një muze të vogël e gjysmë të shkatërruar. Përveç portjerit — një plak i raskapitur e gjithë zhele, — asnjëri nuk kish brenda. Nuk i tregova nga isha dhe kush isha; mua më duheshin ndjenja dhe përshtypje të vërteta, jo fjalë sa për të më bërë qejfin. — Çfarë mund të më tregoni? — i thashë plakut. Ai shkoi drejt vitrinës dhe më tregoi diçka me dorë. U afrova: një mi floriri! Më bëri përshtypje që një muze kaq i varfër, të cilin vetëm leckamanët mund ta vizitojnë, të ketë një monument prej floriri për miun. Vendosa ta bleja këtë skulpturë unike. Nxora bllokun e çeqeve, grisa një fletë dhe i thashë plakut: «Na pesëdhjetë mijë dollarë! Miun do ta marr unë». Prisnja që plaku të hidhesh përpjetë nga gëzimi. Pesëdhjetë mijë dollarë! Mirëpo, për habinë time, propozimi nuk i

bëri asnjë përshtypje. Në vënd që të më falënderonte për gjestin bujar, ai luajti kokën në shenjë mohimi. «Si?! Doni më tepër?» Ai s'po fliste. «Na njëqind mijë!» Hoqa edhe një fletë nga blloku i çeqeve.

Ju ndofta nuk e besoni, por atij njeriu fanatik nuk i lëvizi as një muskul i fytyrës. Me gjaktfohtësinë më të madhe vazhdonte të luante kokën në shenjë mohimi. Nuk durova më dhe i thashë: «Thomëni de, të shkretën, pse ky mi është kaq i shtrenjtë për ju?» Më në fund ai e hapi gojën: «Ky mi është amanet që i takon gjithë popullit. Shumë vjet përpara, shtetin tonë e invaduan miliona minj, të cilët çfarosën gjithë bimësinë. Pllakosi uria. Për të zhdukur fatkeqësinë, populli grumbulloi para dhe iu lut një mjeshtri të urtë të bëjë një mi prej floriri dhe t'ja dhurojë muzeut. Simbas legjendave duhej të ndodhte një çudi dhe çudija ndodhi. Brenda disa orëve minjtë u zhdukën krejtësisht dhe prej atëhere nuk duken më në këto anë».

Tani kureshtja dhe dëshira për ta patur këtë mi të çuditshëm, m'u shtuan më shumë. Jeton tani autori i kësaj vepre? Po? Shumë mirë. Do shkoj t'i jap para sa të dojë që të më bëjë edhe mua një mi si ky.

«Jo, zotëri, — më tha plaku. Mjeshtri ynë i urtë tani s'ka kohë, është shumë i zënë.

«Me se? Unë i jap dollarë, dollarë» — i thashë plakut.

«Nuk mundet, nuk mundet, — m'u përgjegj fakiri. — Populli përsëri ka mbledhur para dhe e ka porositur plakun e urtë të bëjë një amerikan prej floriri, për ta vendosur këtu, në muze!»

E çfarë i thoni ju kësaj? Si mund të përmbahesha para një fakti të tillë? A nuk kam të drejtë të shqetësohem?

Jo, do të thoni ju, se amerikanin, edhe në këtë muze të varfër, e kanë paraqitur amerikan prej floriri. Eh, xhentlëmenë! Të gjithë njëloj janë: si këta fshatarë kokëfortë, ashtu edhe punëtorët e kanalit të Panamasë, apo banorët e leckosur të Santo Domingos. Dikush e bën amerikanin prej floriri dhe e krahason me miun, dikush tjetër e paraqet si dordolec, i ven një helmetë në kokë dhe e djeg publikisht në mes të kolonave të leckamaneve, që demostrojnë. Çfarë ndryshimi ka këtu? Edhe juve, po të ishit në vendin tim, nuk do t'iu zinte gjumi. Po, po. As gjumi nuk do t'iu zinte.

Nëndor 1963.

DIALOGU I TË DËNUARVE

«...Arrija në bazën e Da Nangut. Koinçidencë e çuditshme. Takova shokun tim të shkollës, Dik Xhekson. U dëshpërova, kur pashë se ishte shumë i mërziur e pesimist. M'u duk se fliste përçart dhe më shtiu frikën. Pas atij bisedimi, sikur diçka e tmer-shme më rri mbi kokë...».

(Nga ditari i rreshterit amerikan, Xhejms Uoten, vrarë në Vietnamin e Jugut).

— Çfarë udhëtimi i shkëlqyeshëm, Dik. Aero-planmbajtësja «Enterpraiz» është me të vërtetë një mrekulli.

— Mrekullitë tani fillojnë, i dashur Xhejms.

— O, për këtë s'kam asnjë dyshim. Ti kush e di se çfarë aventurash të bukura ke bërë gjatë këtij viti. Xhungël! Njerëz të egër! Tropik! Dollarë!...

— Pasi vjen këtu, e ndjen se dollarët janë si kapëset e mizave, Xhejms.

— Ëndrat e mija kanë qënë udhëtimet e largëta dhe gjuetia në xhungël.

— Dikur edhe unë kam patur ëndra të tilla.

— Dhe tani nuk mendon më ashtu?

— Se ç'mendoj unë është zor ta kuptosh tani për tani, ser Uoten. Ka vetëm tri ditë që ke zbritur në këtë tokë të mallëkuar dhe akoma nuk e ke nxjerrë hundën përtej telit me gjemba. Nëqoftëse do të jesh fatmirë dhe do të kthehesh nga gjuetia e parë në xhungël, atëhere do të bisedojmë... Ke ardhur me plane të mëdha, Xhejms.

— Suvenirin e parë dua t'ja dërgoj ledit brënda kësaj jave, Dik. I kam premtuar flokët e një vajze të Vietkongut.

— Edhe unë pata grumbulluar suvenirë të tillë për ledin tim, Xhejms. Po tani kam hequr dorë. Në një operacion në një fshat këtu afër, në emër të botës së lirë, i mora vathin një vajze, bashkë me veshin.

— Ky është një suvenir i mrekullueshëm, Dik.

— Veç kushton pak si shtrenjt.

— Sa dollarë?

— Për një vesh gadi lashë kokën, i dashur.

— Ata janë të egër!

— Të egër e njëkohësisht të padukshëm. Ndofta ata e dëgjojnë edhe këtë bisedën tonë. Ky vënd është një mal me thika, një pyll me tunele, një det me kurthe. Njerëzit e këtushëm as helmi nuk i mbyt. Kur hyn në kazermë, çdo objekt ke frikë ta prekësh me dorë, se mund të jetë një bombë e maskuar. Ata janë të padukshëm e njëkohësisht kudo. Kur je në xhungël të duket se ke hypur mbi shpinën e një tigri dhe nuk din se ku të shpie.

— Prej këtu mund të shkosh edhe në Himalaja, në Tibet apo....

— Akoma më tej mund të shkohet. Kjo botë

është e vogël për ne, Xhejms. Shumë shokë kanë zbuluar edhe botën tjetër, duke marrë start mbi këtë truall. Të kujtohet Filip Batleri dhe Nil Harri? Kanë qënë shokët tanë të shkollës, apo jo?

— Edhe ata janë këtu?

— Ishin.

— Po tani?

— E kryen detyrën dhe besoj se nuk do t'u lindë dëshira të kthehen më.

— Kush e di sa dollarë e gjëra të çmueshme kanë grumbulluar!

— ... Në thasë nejloni i mbështollën.

— Me thasë?!

— Desha të them se Filipin dhe Nilin i mbështollën në thasë nejloni.

┌— Asgjë nuk kuptoj, Dik.

— Duket se nuk i lexon gazetat, Xhejms.

— Pothuajse asnjë herë.


— Mirë bën. Flë më rehat kur nuk di se ç'bëhet. Por ndonjë herë edhe duhen lexuar... Në këto depo, që na rrethojnë e që ti i ruan me aq kujdes se mos hidhen në erë nga vietkongët, janë stivosur katërqind mijë thasë për kufomat tona, Dik. Ato do të na jepen pa para. Çka do të mbetet nga Xhejms Uoteni dhe Dik Xheksoni, do të mbështillet në ato thasë!

— Ti po më tmeron.

— Prandaj të thashë se është më mirë të mos i dish gjërat. Edhe unë rastësisht e kam mësuar.

— Por... Ndofta kjo s'don të thotë se ato janë pa tjetër edhe për ne të dy.

— Të paktën nga një thes na takon edhe neve, Xhejms! Edhe sikur ta zëmë se oficerët do t'i



«... Pas atij bisedimi sikur diçka e tmerrshme më rri
mbi kokë...»

mbështjellin me nga dy ose tre thasë, prapë për neve mbetet nga një... Nilit të varfër vazhdojnë t'i vijnë letra nga e shoqja, ndërsa ai është futur në një thes nejloni dhe udhëton pa bërë zë, në hambarët e një anijeje... Pas nisjes së Nilit, unë vendosa të mos jem plotësisht dakord me Bollduinin, që thotë se «rruga për në Vietnam është e gjatë dhe pa kthim». Nili po kthehet. Pati fat ai. Shumë shokë të tij shërbejnë si ushqim për insektet e moçaleve.

— Siç duket ende nuk i kanë treguar së shoqes.

— Formalitet i tepërt... Këtu zhduken kompani të tëra në gjysmë ore. «Shërbimi psikologjik» i Pentagonit e di se çfarë duhet të dijë e çfarë nuk duhet të dijë çdo amerikan i urtë. Po t'i mësosh të gjitha, atëhere ti nuk tregohesh edhe aq entuziazat në mbrojtjen e kufive të Amerikës, dhjetë mijë milje larg brigjeve të saja.

— Megjithatë unë pres me interesim luftimin e parë, Dik.

— Ndërsa unë mezi pres të fundit, Xhejms.

— Djalli nuk është aq i tmershëm, sa e parqesin, Dik. Ti më duke si shumë i frikësuar.

— Paskan punuar mirë me ty, Xhejms. Po të tregoj një legjendë të vogël. Thuhet se jetonte një herë një plak, që i donte shumë dragonjtë dhe gjithë kasollen e vet e pat mbushur me figura dragonjësh. Mirëpo një ditë prej ditësh, ndërsa shëtiste në pyll, plaku hasi ballë për ballë me një dragua të gjallë. Dhe e din se çfarë ndodhi? Plakut i pushoi zemra nga frika... Ti i ke parë vietkongët vetëm në faqet e «Llaif»-it: të lidhur për qafe e të leckosur.

— Ne do t'i mundim ata, Dik. Ndofta unë e ti do të jemi dëshmitarët e fitores. Kam besim për këtë.

— Po të mos kish njerëz si ti, «Shërbimi psikologjik» nuk do të ekzistonte, Xhejms.

— Unë kam dëgjuar me veshët e mi gjeneralin tonë Uestmorlend, kur ka thënë se ne do të fitojmë. Mua më kanë thënë se ai është strategu më i madh i këtij shekulli.

— Gjer në fund të shekullit është akoma larg, Xhejms.

— Ti shikon vetëm anët e zeza, Dik.

— Anët e bardha i shikon presidenti. Atij i takon optimizmi, sepse ai mban fjalime dhe na dërgon thasë nejloni.

— Dik! Si duket, ti dëshëron të futesh në burg.

— Nuk do e ndjeja veten keq. Veshje prej guri të kem. Më mirë se në një thes nejloni. Unë dua të mbetem i gjallë — ja, ëndra dhe dëshira ime e parë dhe e fundit.

— Ti dukesh sikur ke vendosur të vdesësh pa tjetër, Dik.

— Të tjerët kanë vendosur, jo unë. Si për mua, ashtu edhe për ty.

— Ti po më tmeron, Dik. Në fund të fundit, po e pamë ngushtë të biem rob.

— Më parë mëso t'iu përgjigjesh pyetjeve që do të të bëjnë. Ata pa tjetër do të pyesin përse ke ardhur në Vietnam, nga vënde kaq të largëta.

— «Për të ndihmuar aleaten tonë, qeverinë e Vietnamit të Jugut» — do t'iu them unë.

— E paske mësuar formulën... Po sikur të

të pyesin se kush është kryeministri i asaj qeverie që ti e dashke aq shumë?

— ?

— Për këtë nuk qënke përgatitur, Xhejms. Kongresi ynë ka caktuar trembëdhjetë miliard dollarë për të mbajtur në këmbë një qeveri, kryeministrin e së cilës ti nuk e di si e quajnë... Shko pyet komandantin, Xhejms, si duhet të përgjigjesh, po të biesh rob...

Mars 1966.


VAJTIM NË NATO

Në fillim u duk sikur çdo gjë eci mbarë e mirë. Prandaj, për të pagëzuar «bashkimin» e tyre, ata zgjodhën edhe një emër të bujshëm — emrin e një oqeani. Brigjet e oqeanit do të shërbenin si këmbëzat e urës për «bashkimin». Mirëpo, për derisa thuhet se oqeanet janë pa anë e fund, edhe kufitë e bashkimit të projektuar mund të zgjeroheshin pa anë e fund. E pse Greqia, e ndonjë vënd tjetër, të mos ishin vënde atlantike? Gjeografët u habitën në fillim dhe dikush tha se kjo është «gjeografi lesh e li». Por më vonë gjithçka u sqarua. «Mjafton që qeveria e atij vendi të ketë frymë atlantike dhe oqeani e pranon në gjirin e vet» — u dëgjua një zë që vinte që nga ana tjetër e globit.

Dhe ata u bënë pesëmbëdhjetë. Nëpër faqet e gazetave u duk një term i ri: NATO! Pati nga ata që e ngatërruan këtë emër me inicialet e ndonjë bombe apo organizate raciste në Amerikë, por shpejt NATO u bë e njohur si bërthama e të gjitha dokumentave e fjalimeve zyrtare të qeveritarëve të «botës së lirë». Këto katër germa shprehnin jo

vetëm një shtet brenda në secilin prej pesëmbëdhjetë shteteve, por edhe një shtet mbi të gjitha këto shtete. Daj Sami kish të drejtë të fërkonte duart nga gëzimi. Ai jepte mish kutiash dhe merrte ushtarë për në Kore e vendoste baza në tokat e «aleatëve» të vet. «Aleatët» evropianë ishin vënë në grazhd e hanin konserva amerikane. Daj Samit iu duk se po ngjitej drejt kulmit të imperatorisë botërore. Pastaj, «aleanca» midis kalit e kalorësit, a nuk është diçka e përjetshme?

Mirëpo vitet rrodhën në të kundërtën. Që në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare «aleanca atlantike» u transformua në një shtëpi të vjetër prej dërrase, ku fryjnë erërat nga të katër anët. Këtë vit ditëlindja e saj u kthye në ditë zije. Fjalimet e mbajtura me këtë rast në Uashington e në shumë kryeqytete të Evropës perëndimore, qenë nekrologji të vërteta. Gjeneralët në shtabin e Natos, në Paris, nuk patën kohë të merrnin pjesë në asnjë ceremoni, sepse qenë të zënë me planet e shpërnguljes. Për ku? Askush nuk e di me siguri se ku do i ngrenë çadrat në të ardhmen. Godina e re e Shapësë, e ndërtuar vetëm disa vjet më parë e që ka kushtuar shumë miliona dollarë, i përngjet anijes që po mbytet e që kërkojnë ta braktisin sa më shpejt. «Nato është goditur në zemër» — tha Xhonsoni. «Franca do që të zgjidhë martesën me paktin e Atlantikut» — shkruan «Nju Jork Tajms». «Personalitetet e larta amerikane në Paris sillen si ata dashnorët që nuk hasin në ndjenja reciproke: të fyer e të revoltuar» — thotë nga ana e tij publicisti Reston.



-- Pesë minuta zi për mikun e humbur,

Rreth kësaj gjëndjeje s'ka të pushuar lumi i deklaratave, memorandumëve, fjalimeve e mbledhjeve të niveleve më të ndryshme. Natyrisht, kulmi i nervozizmit vihet re në Uashington.

...Në selinë e senatorit Uollstop janë mbledhur kolegët e tij Hams, Bulldog, Gollder, Mortop dhe Full.

Senatori Uollstop: — Xhentelmenë! Kjo është një sëmundje ngjitesë. Unë jam i sigurtë se ato që gjenerali De Gol i thotë hapur, të tjerët i mendojnë fshehur dhe vetëm hë për hë i thonë nën jorgan. Sot Parisi, nesër... djalli e di... Boni, pasnesër, ndofta merr guxim edhe gjyshja jonë — desha të them Anglia. Kush na garanton? Natot, Seatot e Sentot përbëjnë poezinë e politikës sonë. Po t'i heqësh këtë poezi, çfarë i mbetet kësaj politike?

Senatori Hams: — Ajo çka po ndodh, mua nuk më habit, zotrinj. Në kohën tonë mosmirënjohja nuk ka kufi. Për vite të tëra ata jetuan me dollarët tonë, ndërsa tani thonë se nuk u pëlqen dollari si valutë ndërkombëtare. Aviatorët tanë e kanë konsideruar qiellin e Francës si qiellin e tyre, ndërsa tani nxirren në qarkullim terma të harruara si «integritet», «dinjitet», «protektorat» e ku ta di unë...!

Senatori Bulldog: — Vigjilencë, xhentelmenë, vigjilencë! Ky është kyçi i problemit. Për shumë kohë ne e kujtuam Evropën përëndimore vetëm si një muze për turistët e vënd dëfrimi për ushtarët. Ne nuk pamë atje rivalët tanë. Ka tre vjet që ne bisedojmë për të krijuar forcat e 'shumanshme bërthamore të Natos. Dikush thoshte se ato

duhet të jenë të nënujshme, dikush tjetër i donte të mbiujshme. Rezultati? As nën ujë, as mbi ujë! E megjithatë ne nuk pamë se çfarë do të vinte pas këtyre zigzakëve. Ne duhet të kishim thënë: stop.

Senatori Mortop: — Jam shumë dakord me kolegun tim të nderuar. E njëjta gjë ndodhi me ombrellën tonë atomike. Prej kohësh është parë qartë se dikush do që të dalë jashtë kësaj ombrelle, sepse paska shpikur diçka të tijën. Thjeshtë rebelim! Tri herë rebelim! Unë nuk mund ta kuptoj se si tjetri ka guxim të thotë se e ndjen veten më të sigurtë nën çadrën e vet, në një kohë kur ne i japim garanci nën çadrën tonë...

Senatori Gollder: — Ka diçka paradoksale, zotërinj, në politikën tonë. Ne gëzohemi që englezët qeshin me De Golin që do armën e vet atomike, por njëkohësisht nuk duam të shikojmë se në Londër po ndodh e njëjta gjë.

Senatori Hams: — Duhet elasticitet, kolegë. Departamenti ynë ndonjëherë nuk di ta luajë pjesën siç duhet. Dëshironi ndryshime? Po? Dakord. Bëjmë ndryshime. Ne mund t'u dërgojmë aleatëve tanë edhe më shumë ushtarë për sigurimin e tyre, por, natyrisht, edhe ata të na japin ushtarë për nevojat tona. Ne marrim përsipër t'i stërvisim si në luftë të vërtetë, qoftë edhe në Vietnam. Dhe ata do të paguajnë për këtë vetëm shpenzimet e transportit.

Senatori Gollder: — Dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet më parë kjo shaka do të merrej seriozisht, sër Hams. Në kohën e luftës së Koresë, për shembëll. Por sot, disa nga miqtë tanë, jo vetëm përpiqen hapur të varrosin aleancat që ne i quajmë të

shënjtja, por as shpenzimet e varrimit nuk duan të paguajnë. Ne shpenzuam njëzet e pesë miliard dollarë për ta zbukuruar hartën e Francës me bazat tona ushtarake, ndërsa Parisit të vjetër i dhamë pamjen moderne me ndërtesën shumëkatëshe të shtabit të Natos. Tani ata nuk duan të paguajnë asnjë cent për shpenzimet e shpërnguljes. Si e spiegoni ju këtë?

Senatori Bulldog: — Ju flisni për njëzet e pesë miliard, ndërsa mua më shkon mëndja tek njëqind miliardët e harxhuara, gjatë këtyre shtatëmbëdhjetë vjetëve, për perfeksionimin e aleancës sonë, që sot na paraqitet si krejt e pa perfeksionuar. Po të ishin shpenzuar me mënd, me njëqind miliard dollarë ne do të kishim mundur të blenim dyqind aleatë besnikë, si Çan Kai Shija ose Nguen Kao Ki.

Senatori Gollder: — Ju siguroj se është bërë çmos në këtë drejtim, shumë i respektuari senator, por siç duket, tregu i këtyre mallrave është mjaft i varfër dhe ne nuk gjejmë gjithmonë atë që duam.

Senatori Full: — Më falni xhentelmenë, për ndërhyrjen. Heshta gjer tani me shpresë se do të dëgjoja diçka konstruktive nga kolegët e mij shumë të nderuar. Me keqardhje të pafund shoh se gjer tani u thanë vetëm konstatime. Masa, xhentelmenë, masa! Ja, çfarë duhet. Konstatimet janë si fotografitë. Fotografoje objektin dhjetë ose një mijë herë, ai prapë nuk ndryshon.

Senatori Bulldog: — Ndofta, sër Fulli ka propozime konkrete?

Senatori Full: — Nëqoftëse kolegët e mi të nderuar duan të dëgjojnë propozimet e mia, ato

përmbliidhen në një fjalë të vetme: Escalation! Shkallëzim, edhe një herë shkallëzim! Si në Vietnam. Në fillim të përdoret këmbësoria e marinës, pastaj aviacioni...

Senatori Hams: — Kundër aleatëve tanë?

Senatori Full: — Kundër ish aleatëve tanë!

Senatori Gollder: — A do të na mjaftonin ushtarët? Më duket se të dhjetë gishtat tanë janë të zënë...

Bie zilja e telefonit. Senatorët Bulldog e Gollder i kërkojnë me ngut në departamentin e shtetit. Në Vietnamin e Jugut duhet caktuar urgjentisht një kryeministër tjetër.

Prill 1966.

KUKUMJAÇKAT

«Senatori Kreing Hosmër, republikan nga Kalifornia, u propozoi autoriteteve të Uashingtonit përdorimin e kukumjaçkave dhe letrave të lojës si mjete psikologjike për të fituar luftën në Vietnam».

(AFP, 19 mars)

Ai nuk kish mbajtur ndonjë herë fjalime të gjata. Shtypi nuk e kish përmendur kurrë emrin e tij. Edhe kur i pat qëlluar një herë të fliste në lidhje me një ligjë për qentë shtëpiakë, kërkush nuk e mori në fotografi. Kjo mospërfillje e pat dëshpëruar, por me kalimin e kohës u pajtua me gjëndjen dhe në debatet e gjata vepronte ashtu si shumë kolegë të tij: dremiste në kolltuk ose shkonte në dhomat e pushimit e bënte një sy gjumë, gjersa shërbyesit e senatit vinin dhe e zgjonin sepse debati kish mbaruar e duhej bërë votimi.

Edhe kësaj radhe ai po dremiste. Kish tre ditë që vazhdonte «flibustjeri»¹⁾ kushtuar gjëndjes në Vietnam. Një punë shumë e lodhshme kjo, pra ndaj


1) Diskutime të pandërprera.

koka i qe varur në gjoks dhe ajo pjesa e sipërfaqes pa flokë jepte një reflektim të zbetë të dritës elektrike. Zilja e kryetarit të mbledhjes e solli në vete dhe i ndërpreu në mes ëndrën, e cila më vonë do ta bënte të njohur.

Tek ish i mbyllur në kabinetin e tij, një mendim i papritur i shkrepri në kokë... Fundi i fundit edhe nëqoftëse senatorin Hosmër nuk e kanë pushtuar ndonjë herë ide gjeniale, kjo nuk do të thotë se ai nuk është në gjëndje të shohë ëndra të mëdha.

Të nesërmen, me sy të buavitur e fytyrë të vrrarë, ai u ngjit në podjum. Mikrofonat e vështro- nin si gojë të hapura.

«Xhentëlmënë! Unë dua të propozoj këtu mjetin më të thjeshtë e më efektiv për të fituar luftën në Vietnam. (Asnjë lëvizje në sallë). A keni menduar ndonjë herë zotrinj, se në Vietnam kemi të bëjmë me një popull shumë fanatik? (Përsëri heshtje. Asnjë përgjigje). Ne duhet ta shfrytëzojmë këtë rrethanë. Nuk na duhen as bomba, as ushtarë për të fituar luftën. Na duhen vetëm kukumjaçka. (Ilaritet në sallë. Senatorët nisën të lëvizin nga vëndi. Operatorët e televizionit drejtuan kamerat: Sensacion!) Nëqoftëse ne do të hedhim kukumjaçka të mjaftueshme mbi teritorin e Vietnamit, të cilat do të këndojnë mbi çatitë e shtëpive vietnameze, atëhere banorët e këtij vëndi do të dëshpërohen, morali i tyre do të bjerë dhe neve nuk na mbetet tjetër veçse të festojmë fitoren. (Ilaritet në sallë. Kamerat e televizionit filluan punën. Reporterët i prenë bisedat e zhurmshme midis tyre). Xhentëlmënë! Ndonjeri prej jush mund të kujtojë se kuku-



— Dhe për ne paskan nevojë

mjaçka është vetëm kukumjaçkë. Jo, zotrinj, nuk është aspak ashtu. Këtë mund ta thonë vetëm ata që nuk kanë patur rastin t'u këndojë kukumjaçka mbi çati. Unë nuk jam supersticioz. Çdo gjë e them nga eksperiencia personale. Vdekja e gjyshes sime, një vit më parë, nga kukumjaçka u paralajmërua. Dje, zotërinj, pashë në ëndër sikur ajo e mallëkuar erdhi përsëri në pezulin e dritares sime dhe këndoi tri herë me radhë. A e mendoni se çfarë efekti ka bërë tek unë kjo ëndër? Po sikur kjo të ndodhte me të vërtetë? Akoma edhe tani jam nën përshtypjet e asaj ëndre të tmershme. Merreni me mend pastaj, se si do të pritej zëri enigmatik i kukumjaçkës nga vietnamezët fanatikë. Në atë vënd ka diçka misterioze. Unë jam i bindur se të nderuarit senatorë i lexojnë gazetatat. Prandaj marr guximin të pyes se si mund të spiegotet fakti që neve harxhojmë mijëra ton bomba dhe kur zbresin parashutistët tanë në tokë për të parë rezultatet, nuk gjejnë asgjë? Ku shkoi ajo mori njerëzish që nxinte disa orë më parë? Apo vëzhgonjësit tanë mashtrohen nga ndonjë vizion misterioz? Si është e mundur që njerëzit të mbijnë nga toka dhe, sa hap e mbyll sytë, po toka t'i përpijë? Kush nga kolegët e mi të nderuar di të më spiegotë enigmën e pyllit të madh Bao Loi, në Vietnamin e Jugut? Ai pyll është qëndra e atyre qenieve, që unë do t'i quaja mistike. Aviacioni ka hedhur mijra bomba me napalm në atë pyll, po a mendoni ju se është djegur? Aspak. Tymi dhe avulli i flakëve kthehen menjëherë në shi. Zjarri shuan vetëveten...! Cila forcë mund të bënte një gjë të tillë, veçse diçka e mbinatyreshme? Nëqoftëse ndonjeri din

ndonjë shembull të ngjashëm, le ta thotë... Njerëzit që nuk besojnë në forcën e armëve, ose që nuk u nënështrohen atyre, duhet të besojnë në diçka tjetër misterioze. Prandaj le të mos i nënvleftësojmë kukumjaçkat, të cilat me zërin e tyre enigmatik do t'iu paralajmërojnë disfatën kundërshtarëve tanë. Mos harroni zotrinj se penicilina ka dalë nga myku. (Zhurmë në sallë. Kryetari i mbledhjes i bie ziles).

Një zë nga salla: A ka menduar i nderuari senator Hosmër se ku mund të gjendet gjithë ajo mori kukumjaçkash, që do të duheshin për një teritor, kaq të hapur?

Senatori Hosmër: Po të merret çështja seriozisht, mund të gjenden. Nëqoftëse nuk na mjaftojnë kukumjaçkat tona (megjithëse unë jam i bindur se Amerika ka shumë kukumjaçka), atëhere mund të rritet kapaciteti i inkubatorëve në Seul, Taipëh ose Saigon.

Një zë nga salla: Po nëqoftëse zëri i kukumjaçkave do të dëgjohet edhe nga ushtarët tanë, a nuk ka rrezik që edhe ata do të preken për keq?

Senatori Hosmër: Me këtë çështje duhet të merret shërbimi ynë psikologjik në Azinë jugë-lindore, i cili, me sa duket, i ka përdorur gjer tani të gjitha mjetet që kish në dispozicion; prandaj mund t'i kushtohet plotësisht stërvitjes së kukumjaçkave.

Prill, 1966.

MOS BËNI BISHT!...

Togeri Gob Taps u habit, kur i thanë se ai do të bënte pjesë në një komision për marrjen në provim të studentëve të universitetit të Çikagos. Asnjë herë ai nuk kish marrë një njeri në provim dhe as i kujtohej si i kish dhënë provimet e veta. Për shkaqe që ai nuk dëshironte t'i përmëndte, që në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare e kish parë të arësyeshme të mos shkonte më në shkollë... Ai me të vërtetë qe dalluar në një operacion kundër gueriljeve në Guatemala (emri i tij qe përmendur edhe në revistën «Kolliers»), por çfarë lidhje kish midis Guatemalës dhe provimeve të studentëve?

— Mos u shqetëso, toger, i tha koloneli Tup Birç. Gjithshka do shkojë në rregull. S'ka asnjë filozofi në këtë mes. Ne do të provojmë vetëm pjekurinë e të menduarit tek studentët, në atë shkallë sa i duhet të dijë një këmbësori të marinës. Komisionin do e kryesoj unë.

— Ka rrezik që ata të na ngatërrojnë me ndonjë formulë, tha Tapsi.

— Ne nuk hyjmë në formula të ngatërruara. Pyetjet do të jenë nga më të thjeshtat që mund

të ekzistojnë. Aq të thjeshta sa që ata të mos guxojnë të thonë se nuk i dinë.

— Po nëqoftëse...

— ...S'ka asnjë «nëqoftëse»! Ne nuk futemi në hollësira. Aftësia e të menduarit që na duhet neve nuk ka të bëjë aspak me atë se sa gjëra të mëdha përmban kafka e këtij ose atij tipi. Neve na duhen ushtarë. Koka, si do që të jetë, po të mbështillet mirë me një helmetë të hekurt, hyn në punë. Bile kisha për të thënë se, në këto raste, pjekuria e tepërt ngatërron me keq. Shpesh herë ajo shoqërohet me gjithfarë pyetjesh të panevojshme mbi qëllimet e luftës në Vietnam e ku ta di unë. Neve na duhet të provojmë se ata nuk kanë nevojë të studjojnë më tej dhe se janë të lirë të shkojnë ushtarë. Vetëm kaq.

— Po unë, çfarë..?

Kolonel Birçi përsëri nuk e la togër Tapsin ta vazhdojë fjalën gjer në fund.

— ...Ti një gjë duhet të kesh kujdes. Studentët janë djaj. Do të mundohen t'u bëjnë bisht pyetjeve.

— Aha, bishtat i pres unë, — u hodh togër Tapsi.

Të nesërmen, kur studentët u thirrën në sallat e universitetit, nuk panë asnjë profesor. Tek porta qëndronte një roje e armatosur. Kolonel Birçin e rrethonin katër oficerë. Para tyre, në tavolinë, secili kish një grumbull dosjesh. Një hartë e Vietnamit varej në mur dhe u qëndronte mbi kokë, si një kosë.

— Emrin? — iu drejtua kolonel Birçi studentit që u ul në bankon përpara tij.



Në provim

— Kllod Liverson.

— Na thoni, student Liverson, cilat janë katër veprimet e para të aritmetikës?

Kllodi hapi sytë i habitur.

— Nuk i dini? — pyeti koloneli.

— Mos bëni bisht! Përgjigjuni! e ngriti zërin toger Tapsi.

— Unë jam i kursit të katërt. Për një vit diplomohem në shkencat e matematikës dhe...

— Këto janë bishtra! — thirri përsëri toger Tapsi.

— Nuk është punë bishti, tha Liversoni, me zë të dridhur. Këtu është punë koke, desha të them formula kryesore...

— Aq më mirë, — ndërhyri kolonel Birçi. — Kjo do të thotë se katër veprimet e para të aritmetikës ju duhet t'i dini; bile mund të them se ju i dini. Regjistrojeni! — tha ai, duke iu drejtuar sekretarit që rrinte në të djathtë. Tjetri!

Liversoni u largua si i hutuar. Vëndin e tij e zuri Çarl Diçi.

— Cilat janë organizmat e gjalla më të thjeshta!, vazhdoi koloneli.

— Unë jam në vitin e katërt të biologjisë dhe...

— Kjo nuk do të thotë se ju nuk i keni mësuar akoma organizmat më të thjeshta, ndërhyri koloneli.

— Ju doni t'i bëni bisht pyetjes, u nxe togeri Taps.

— Organizmat më të vogla nuk kanë bisht, u përgjegj Çarli.

— Meqënëse ato nuk kanë bisht, regjistrojeni, urdhëroi kolonel Birçi. Pyetjen e dini mirë. Plo-

tësisht i aftë për në radhët e këmbësorisë së marinës. Në Vietnam!

— Unë në Vietnam?

— Tjetri! — bëri me dorë koloneli.

Roja, që rrinte në portë si i ngrirë, tani lëvizi nga vëndi dhe e nxori Çarlin nga porta tjetër e sallës.

Koloneli fshiu syzat dhe mërmëriti nëpër dhëmbë: «Vietnami, Vietnami!»! Dhe, kur ngriti kokën, pa se përpara tij qëndronte një student i hollë e i gjatë, si steka e biljardos, me sytë gjysëm të mbyllur.

— Çfarë studjoni ju? pyeti koloneli, duke shtrembëruar kokën për të parë mbi syzat, që i vareshin në fytyrën e buavitur e të përgjumur.

— Diplomaci, u përgjegj studenti.

— Mirë, shumë mirë. Dini të na thoni ju përse luftojmë ne në Vietnam?

— ?!

— Student Xhekson! Përse luftojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Vietnam?

— Sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan Vietnamin.

— Edhe kështu mund të thuhet. Por më qartë, Xhekson, më qartë.

— Më qartë s'ka si thuhet, tha Xheksoni duke mbledhur krahët.

— A mund të na thoni ju, ku shtrihen kufijt e SHBA?

— Po ja, nga Alaska e gjer në brigjet e Kalifornisë.

— Mos bën bisht! Po Vietnami, Guatemala, Evropa?

Toger Tapsi u skuq si tjegulla, u ngrit e mori qëndrim gatitu.

— Ju më pyetët për Amerikën.

— Njëlloj është!, bërtiti toger Tapsi. Pse, ata çfarë janë?

— Regjistrojeni dhe merni shënjat e gishtërinjve, urdhëroi koloneli me zë të qetë. Ai fshihi edhe një herë syzat dhe pyeti se kush e ka radhën.

— Ralf Koti — u prezantua studenti i porsardhur.

— Ju përgatiteni për jurist? Po?

— Siurdhëroni, sër kolonel.

— Ç'mendoni për teorinë e shkallëzimit?

— Një ide gjeniale!

— Si jurist i ardhshëm, a mendoni se ajo do të gjejë përdorim të gjërë në fushën ndërkombëtare?

— Bile edhe në fushën kombëtare.

Koloneli hoqi syzat.

— Përgjigje interesante. A mund të na jepni një shëmbull?

— Po ja... për të qetësuar universitetet tona.

— Dhe si, pikërisht?

— Të përdoren pushkatarët e marinës për të bindur studentët.

— Ata duhen në Vietnam, Domenikë, Guatemalë, u hodh toger Tapsi.

— Atëherë të përdoret aviacioni sër kolonel. Në fillim të bombardohen rrugët që shpien në universitetet, pastaj sheshet sportive, pastaj oborret, në fund konviktet!

— Ide e mrekullueshme, u hodh gjithë gëzim togeri Taps: Për ku ta shënojmë këtë?

Qershor, 1966.

LEHJA E TARTABIQEVE

A lehin tartabiqet?

Po. Ne ato i dëgjojmë shumë shpesh të lehin, bile me zhurmë. Ato lehin përmes mikrofonave të «Zërit të Amerikës», lehin në emër të departamentit të shtetit të SHBA, ose nëpër zyrat e asaj që, për ironi, e quajnë «Shtëpi e bardhë». Kjo lloj tartabiqe ka aftësi të pakufizuara: bën deklaratata, të cilat pastaj gazetata i komentojnë me bujë; ajo kërcënohet e përpiket të kafshojë edhe në distancë të largët. Nga një herë, kjo lloj tartabiqje mban etiketa zhurmëmëdhja dhe një suitë të tërë me tartabiqe më të vogla e thatanike, që i heqin kapelën e lehin së bashku. (Në këto raste, tartabiqja me etiketë të madhe, kthehet në dirigjent për tartabiqet më të thata, bën xheste të prera e të ashpra).



Qëllon që tartabiqet jo vetëm të hanë njëra tjetrën, po edhe të ngrihen në mbrojtje të njëra tjetrës (sipas rastit). Kur piratët dërgohen në Vietnam të ngarkuar me armë e gaze helmuese, kur piratët vrasin fëmijët e shuajnë bimët, tartabiqet bëjnë gjumin e tyre letargjik, heshtin, ose edhe justifikojnë... në interes të «botës së lirë»! (Se edhe tartabiqet kanë «botë të lirë»). Por kur pi-

ratët kapen në vëndin e krimit, tartabiqet vihen në lëvizje, lehin, këlthasin, dëshpërohen, zemërohen, humbasin gjumin, kërcënohen.

Po në këtë shkrim nuk e kemi fjalën vetëm për tartabiqet në kuptimin figurativ. Fjala është pikërisht për atë tartabiqe që, gjatë muajve të verës, zhvillohet nëpër shtërfaqet e dërrasave e që iu shkakton aq shqetësime njerëzve. Në saje të «shkencës» amerikane ka mundësi që, tani e tutje, njerëzit që banojnë në të dy anët e Atlantikut, të mos i vrasin më tartabiqet si insekte parazitare (ashtu siç mund të kenë bërë gjer më sot), por, përkundrazi, të bëjnë çmos për t'i zhvilluar ato e për t'ja dhënë pastaj të gjithfuqishmit të tyre në Uashington, si ushtarë për luftërat e tij të përtej detit. «Shkencëtarët», që banojnë në Pentagon, e përmbyshën konceptin e vjetër mbi tartabiqen dhe nxorën në dritë se mbytja e një tartabiqeje të zakonshme është (as më shumë e as më pak) barazi me vrasjen e një ose disa ushtarëve amerikanë në Vietnam!

Lexonjësi le të mos e humbasë durimin. Këto reshta nuk janë aspak fantazi e autorit. Për të vërtetuar këtë, mjafton t'i referohemi një organi në zë, siç është agjencia «Rojter». Më 7 qershor ajo njoftonte nga Uashingtoni:

«Shkencëtarët amerikanë po zhvillojnë një armë të re për ta përdorur kundër Vietkongut në Vietnam — tartabiqet që do të lehin si qentë. Këto tartabiqe nuk do të kafshojnë, por do të zbulojnë guerilet me anën e nuhatjes... Shkencëtarët ushtarakë po punojnë mbi mënyrat e zhvillimit të të lehurit të tartabiqes kur nuhat një viktimë — në



largësira gjer më 200 jard, — në mënyrë që të lehurit të bëhet i ndigjueshëm për veshët e njeriut. Zyrtarët thanë se kur shkencëtarët t'i zhvillojnë këto, njësitë e zbulimit që ecin përpara patrullave të xhunglave, do t'i mbajnë me vete tartabiqet për të dhënë paralajmërimin për gueriljet e fshehura...».

Është e qartë se tartabiqen e pret një mision i lartë, ajo përgatitet për beteja të mëdha, ajo është ftuar të jetë luftëtare e «botës së lirë», të mbrojë pavarësinë e Amerikës në... Vietnam, Filipine, Domenikë, Kongo... Tani e tutje tartabiqet do të jenë përçuese të idealeve të mëdha, ato do të lehin në emër të vetë Xhonsonit!

Duke njoftuar për këtë «zhvillim» të shkencës ushtarake amerikane, revista franceze «Karrfur» i porositi lexonjësit të mos qeshin edhe aq shumë, sepse nuk është mirë me qeshë me fatkeqësinë e të tjerëve.

Fatkeqësia e «teoricienëve të tartabiqeve» është me të vërtetë e pafund.

Korrik, 1966.

TUNELI I ERRËT

Bill Mejersi, zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, shquhet për shprehjet e errta dhe enigmatike në të gjitha konferencat e shtypit. Megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet kur ai shprehet hapur e sinqerisht. Kjo ndodh kur Billi shkruan në ditarin personal, faqet e të cilit kanë afërsisht këtë përmbajtje:

13 prill 1966. — Nesër nisemi për në Meksikë. Presidenti urdhëroi që të përgatitet një fjalim me shprehjet më të bukura për miqësinë me Meksikën. Për të qenë në rregull me faktet, kërkova të më sjellin gjithë dosjen meksikane të shtypit. U dekurajova. Në kohën kur ne përgatitemi të themi fjalët më të mira për meksikanët, gazeta «Diario de Meksiko» shkruan: «A e din presidenti amerikan se ambasadori i tij ka marrë pjesë në vrasjen e Maderos dhe të Suárezit, presidentit dhe nënprezidentit të Meksikës?... A mundet që fitorja e palavdishme e «Junaited fruitit» kundër Guatemalës të jetë një burim krenarie?... Po grushtet e shtetit në Argjentinë e gjetkë?»

Ndofta do të na duhen maska antigaz? Kur Ajzenhaueri vizitoi Meksikën, derdhi lot. Shpresoj-

më se policia do të jetë më e kujdesshme kësaj here.

14 prill. — Duket se nuk do të jetë edhe aq e vështirë. Tani për tani rojet janë të mjaftueshme. Aeroporti më duket si aeroplan-mbartësja «Entërpraig» e Flotës së shtatë. Sikur të mos lexosh gazetatat dhe të mos dëgjosh studentët, krijon përshtypjen se në Meksikë gjëndesh në një oazis të qetë amerikan... Presidenti thotë se nuk dëshiron të largohet nga telefoni më shumë se 25 metra. Prandaj në aeroplanin dhe automobilin e tij është instaluar telefoni. Tek statuja e Abraham Linkolnit është vendosur, gjithashtu, një linjë ndërkombëtare. Tek monumenti i pavarësisë presidenti ndenji vetëm dy minuta, po dhe atje u instalua radio-telefoni. Njëzet e katër orë vizitë — 52 telefona, të lidhur me Shtëpinë e Bardhë, Saigonin, Moskën, Berlinin. Ky qe rezultati më konkret i kësaj vizite...

I shkreti plak, sa i shqetësuar që është! Sot e dëgjova të thotë: «Jetojmë në një botë të vështirë».

16 prill. — Jam i kënaqur. Nuk e kaluam edhe aq keq. Plaku nuk derdhi asnjë pikë lot nga gazetarat lotsjellëse. Policia jonë meksikane duket se ka nxjerrë mësim nga vizita e Ajkut më 1960.

30 prill. — Kur hyra në zyrën e presidentit m'u krijua përshtypja se kinezët kishin bërë një provë tjetër atomike. Plaku kish një fytyrë të vrrarë, sikur kish pirë uthull, — tamam si ditën kur u bë prova e parë e kinezëve.

— Merreni këtë dhe mos i jepni asnjë përgjigje shtypit. Iu thoni se «po studiohet».

Ajo ishte një notë e re e De Golit. U largova pa shkëmbyer asnjë fjalë tjetër me presidentin. Xheni më tha se kanë filluar të pyesin gazetarët se cili është reagimi i Shtëpisë së Bardhë në lidhje me afatet që cakton De Goli për tërheqjen e trupave dhe bazave amerikane nga Franca. Unë nuk u përmbajta dhe u përgjigja ashpër: «Në djall të venë gazetarët!». Kjo shprehje më doli spontanisht, kur pashë një grumbull gazetash të nënvizuara nga Xheni, me laps blu. Kjo donte të thoshte se të gjithë flasin tani për politikën e Amerikës, megjithëse Amerika nuk ka shpallur ndonjë politikë të re. Këta djaj i nuhasin gjërat para se t'i bien në dorë presidentit; pastaj pyesin se çfarë mendon ai. Ju a themi hapur xhentëlmenë të kontinentit tonë evropian: ne nuk mendojmë si ju. Ju po e ndryshoni qëndrimin, jo ne. «Figaro» shkruan si pa të keq: «Lamtumirë Shape. Zaret u hodhën...», «Oror» njofton me krenari se «një ditë do të ulen flamurët». Po. Shumë mirë që presidentit nuk i jap mundësi t'i lexojë këto gazeta me nota nekrologjike. Edhe pa to ai e ka kokën plot me telashe. Unë nuk mund ta marr me mend se çfarë shprehje do të merrte fytyra e tij, po të lexonte gazetën belgjiane «Purkua pa», që thotë: «Amerika duhet të vizitohet tek ndonjë psihiatër».

2 maj. — Sot presidenti që në formë. Fjalimi i tij në konferencën e shtypit kushtuar NATO-s dhe Evropës, më emocionoi. Ai më ringjalli kohën e artë kur Evropa sa s'quhej shtet amerikan.

10 Maj. — Po bëhet gjithnjë e më i vështirë çensurimi i materialeve të shtypit, që i jap presidentit çdo mëngjes. Nëqoftëse i heq të gjithë ar-

tikujt që e kritikojnë dhe e fyejnë kryetarin e shtetit, shpejt do të vijë dita kur s'do të ketë ç'të lexojë. Tani nuk është vetëm shtypi i huaj, ai që ngacmon. Edhe disa gazeta e komentatorë nga tanët kanë filluar ta teprojnë, për të fituar pika në opinionin publik. Lipmani shkruante para disa ditësh: «Thirrjet tona prekëse për ta mbajtur NATO-n ashtu siç ishte 15 vjet më parë, — dmth për ta mbajtur pacientin në krevat si një invalid të përhershëm, me shpresë se duke e mbajtur në krevat, do të shërohet nga sëmundja e tij origjinale — janë krejtësisht boshe». «Nju Jork post» thotë se Rasku është iluzionist që duhet të dalë në pension, ndërsa «Njus Uik» jep hollësiara për të mbështetur deklaratën e Fullbrajtit se «Saigoni është shtëpi publike amerikane»... Çdo ditë më forcohet mendimi se leximi i gazetave nga presidenti është diçka jo e këshillueshme.

1 Qershor. — Mbrëmë presidenti u fal në kishë dhe mori pjesë në një meshë kushtuar ushtarëve amerikanë të vrarë në Vietnam. Asnjë herë nuk më është dukur aq i penduar. A është presidenti fetar? Kush e di... Po ai mban në dorë një kryq të vogël të florinjte dhe i pëlqen t'i tregojë objektet me anën e tij. Dje po bisedonte me Raskun përpara hartës së Vietnamit dhe, kur po thoshte diçka rreth bazës së Danangut, kryqi i ra në tokë. Presidenti u nxi në fytyrë dhe... (këtu nuk lexohen disa radhë). Edhe më parë më kishin thënë se plaku e ka për keq, po t'i shpëtojë kryqi nga dora...

5 Qershor. — Kur mbaroi konferenca e shtypit për Vietnamin presidenti qe aq i lodhur, sikur dilte nga një fushë futbollit. Sot nuk bëri asnjë për-

pjekje për të pritur «penalltitë», që i vinin nga qoshe të ndryshme të sallës. Për shumë gjëra nuk u përgjigj fare. Ndonjëherë, ai më dukej si një lojtar i përgjumur, që i vjen topi te këmba, por vetëm e prek atë, nuk e shuton. Unë i thashë pas-taj diçka në vesh dhe ai u ngrit e bëri deklaratën e tij solemne: «Nuk besoj që të ketë në botë një njeri tjetër, që ta dojë paqën aq shumë sa unë». Salla u gjallërua nga të qeshurat. Megjithse këtë frazë unë e kam dëgjuar që kur presidenti bënte fushatën elektorale dhe, më vonë, në çdo konferecë shtypi, kësaj here më preku me mënyrën si e tha. Kur u kthyem në kabinetin e tij të punës, ai më pyeti:

— Bill, ç'mendon ti për budistët vietnamezë?

— Edhe unë habitem.

— Po ai... si i thonë?... (këtu presidenti sikur u ngatërrua; ka ca kohë që nuk i mban mend emrat).

— ...Kao Ki — i erdha unë në ndihmë.

— Po. Kao Ki. Si mendon ti? A do e qetësojë gjëndjen ky Kao Kija?

— Me ndihmën tonë, po.

— Sigurisht, me ndihmën tonë. Por e dini, Bill, si ka thënë djalli, kur qethi macen? «Shumë zhurmë e pak lesh» — kështu ka thënë.

Ishte i zemruar. Unë heshta. Ai m'u drejtua sikur po më jepte mësim:

— Ki parasysh, Bill. Vetëm vietnamezi i vdekur është vietnamez i mirë për ne.

Presidenti uli kokën dhe me gishtin tregonjës të dorës së djathtë preku pulsën. Ai e bën këtë sa herë zemërohet.

Uestmorlend — Mos u zemro zoti president, herën
tjetër ju siguroj se do të kthehem me fitore.



10 Qershor. — Zoti e di. Ndofta unë do të jem biografi i presidentit të 36-të.

13 Qershor. — Lipmani vazhdon të hedhë në erë fraza të kripura. Ai thotë: «Amerika të kujton një kafshë parahistorike, që ka dhëmbë e guaskë, por nuk ka tru». Por jam i sigurt se sikur Lipmani të bëhej president, nuk do të vepronte ndryshe nga administrata jonë.

14 Qershor. — «Gjuha i është dhënë njeriut për të fshehur mendimet e veta». Presidenti e ka parasysh këtë parim të diplomacisë sonë, por sot më duket se e shkeli. Kur e pyeti një korespondent se si duhet kuptuar «teoria e dominosë» në Azinë jugë lindore, ai e tha hapur: «Po ra Vietnami, bie edhe Tailanda, bien Malaizia, Filipinet dhe gjithë Azia Jugë lindore. Po qëndruam në Vietnam, ne do kemi mundësi të qëndrojmë në të gjitha këto vënde». Më vonë, unë i thashë plakut se nuk duhet t'ua tregojmë të gjitha të fshehtat kambanaxhijve. Ai e kuptoi se e kish shkëlur dhe tha se po i buçisnin veshët dhe i dukej sikur nga të katër anët bien këmbanat. Pleqëri apo dëshpërim?

20 Qershor. — Xheni, ti je, e mrekullueshme. Sot më shpëtove nga një gabim i pafalshëm. Unë dhashë urdhër t'i jepet presidentit revista «Njus Uik», po ti më pyete me delikatesë: «Bashkë me këtë anekdotë?» Anekdota thoshte: Një udhëtar po kalonte buzë lumit dhe pa se po mbytej një njeri. Udhëtari u hodh në lum dhe e shpëtoi. Kur doli në breg, njeriu që po mbytej i tha shpëtimtarit të tij: «Unë jam presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kërkoni çfarë të dëshëroni». Udhëtari vështroi si i frikësuar dhe tha se

kërkonte vetëm një gjë: mos i tregoni asnjë njeriu për atë që bëra!

Ah, Xheni, ti meriton më shumë.

22 Qershor. — Megjithë respektin që kam për Fullbrajtin, disa herë nuk e duroj dot. Në sytë e presidentit, mbrëmë, ai tha: «Amerika është duke treguar disa shënja të atij veprimi fatal të shtrirjes së tepruar të fuqisë dhe të misionit të saj, si ato që sollën shkatërrimin e Athinës së vjetër, Francës së Napoleonit dhe Gjermanisë naziste».

Unë nuk e kuptoj përse këta njerëz gërmojnë në histori. Nëqoftëse historia qënka vetëm për të na dekurajuar, atëhere ajo nuk na duhet fare, bile duhet zhdukur. Shumë mirë ka thënë Bernard Shou: «Mësimi i historisë qëndron në faktin se ne nga historia nuk nxjerrim asnjë mësim».

29 Qershor. — Zakonisht ndjej kënaqësi të veçantë, kur lexoj Biblën. Dhe gjithmonë sikur gjej veten time në t'ë. Njerin nga personazhet e mitologjisë — Sizifin — Zoti e ka dënuar të ngrerë gurë të mëdhenj e t'i çojë në majë të malit dhe pastaj t'i rrokullisë prej andej. Edhe mua më duket sikur bëj të njëjtën gjë sa herë përgatit konferencat e shtypit të presidentit, kushtuar paqës në Vietnam.

9 Korrik. — ... Kohët e fundit ai flet pak dhe nuk të shikon në sy. Ndërsa bisedon me mua, nuk ja shqit sytë një harte në faqen e murit për karshi. Gjer tani vonë harta rrinte gjithnjë e mbuluar me një perde jeshile që lëviz me sustë. Kohët e fundit harta me shigjeta shumëgjyreshe është gjithnjë e zbuluar. Mua më ka mërziur ajo hartë e nuk dua ta shoh më... Dje, duke e vështruar hartën, pre-

sidenti harroi dhe e futi cingaren e ndezur në xhep, e në vënd të saj mori kryqin. Filloi t'i dalë tym nga xhepi dhe unë u gjenda ngushtë... Ky Vietnami edhe në hartë është i rrezikshëm.

5 Gusht. — Mbrëmë nuk kam fjetur fare. Jo, nuk qesh i dehur dhë as ishte «Uik end». Po m'u duk se qe fundi i ne të gjithëve. Presidenti ndenji gjithë natën me gjeneralin Uestmorlend, komandan-tin tonë në Vietnam. Unë nuk fola asnjë fjalë dhe kjo më torturoi më tepër. Ndërsa po dëgjoja njoftime aq pesimiste nga goja e gjeneralit që gjithmonë ka folur me optimizëm, mendja më shkoi tek gazetarët, që më presin çdo mëngjes rreth Shtëpisë së Bardhë. Çfarë t'iu thuash atyre?

Dikur presidenti ka bërë thirrje: «Amerikanë! Mos humbisni durimin, kur nuk shikoni dritë në fund të tunelit!» Mbrëmë ai e kish humbur durimin dhe mua tani më del përpara një tunel i errët e pa fund.

Gusht, 1966.

LUTJA E KAPELLANIT AMERIKAN

Prifti Dog Bellc qe raskapitur nga lodhja. Ai nuk kish patur asnjëherë aqë shumë «klientë» për të dërguar në atë botë, sa atë ditë. Për një shenjteri si Dog Bellc është punë e mirë, kur ka «klientë» të mjaftueshëm për në atë botë, se fundi i fundit këtë ja kërkon detyra, por ama, çdo gjë me masë. Atë ditë ai u lodh aqë shumë, saqë, për herë të parë, iu duk se dikur edhe ai mund të bëhet «klient» i ndonjë kolegu të tij, ashtu si ai rrjesht kufomash të ushtarëve të vrarë, që shtriheshin aty pranë.

Kur zbriti me helikopter në një lëndinë të vogël të rrethuar nga pylli i dendur i xhunglës, shenjterinë e tij Bellc diçka e shtrëngoi në grykë dhe po i pengonte frymëmarrjen. Jo, kjo nuk ishte dora e ndonjë «Vietkongu», por ideja, frika se mos... Çdo gjë mund t'i ndodhte në këtë vënd të tmershëm... Ai fërkoj lehtë lehtë mjekrën me dorën që i dridhej dhe e vështroi me sytë e tij të ftohët vargun e gjatë të klientëve që e prisnin të renditur si në formacion luftimi. «Klientët», që të gjithë, ishin maskuar me tabute prej xingoje, që mbanin një markë të njohur për Dog Bellcin, sepse kudo që shkonte i dilnin përpara këto tabute xingoje. Prifti Dog Bellc do të bënte shërbesën fetare dhe gjithë ato tabute xingoje do të mirrnin rrugën

për në bregdet, prej ku, nga hambarët e vaporëve amerikanë, do të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Gjithçka shkonte simbas planit, me të vetmin ndryshim të vogël se, kur erdhën nga Amerika në Vietnam, këto kufoma ecnin me këmbët e tyre, ndërsa tani rrinë shumë të qetë nëpër tabutet prej xingoje, ose edhe në thasët e neilonit.

Prifti pyeti për emrin e atij që shtrihej në tabutin me numur një.

— Xhim Hellsou — i thanë.

Prifti hapi një libër të vogël dhe, duke ngritur kryqin lart, murmuriti diçka nëpër dhëmbë. Kur mbaroi së lexuari ai lëvizi kryqin në ajr, duke vizatuar një shenjë abstrakte dhe përsëriti: «Paqa e përjetshme qoftë mbi ju.»

— Po këtë? — pyeti prifti, duke bërë me kryq në drejtim të tabutit me numër dy.

— Felxhem Xhonson, toger — iu përgjigjën, — ra në kurthin me shtiza.

— «Paqa e përjetshme qoftë me ju, bir i perëndisë», tha prifti nëpër dhëmbë. Pastaj ai kaloi tek i tretë, i katërti, i pesti... Nuk pyeti më për asnjë emër, libri i vogël me lutjet fetare i mbeti në dorën e majtë; dora e djathtë me kryqin dukej si e ngrirë. Prifti përsëriste diçka që asnjëri nuk e kuptonte.

Kur arriti tek numëri shtatë, diçka e llahtarshme shpërtheu diku, aty afër dhe nuk mbeti asnjë dëshmitar për të treguar se çka ndodhi më tej. Të gjithë i mbuloi «paqa e përjetshme», bile edhe priftin Dog Bellc.

Ky lajm solli shqetësime të reja në shtabin e priftërinjve të ushtrisë amerikane në Saigon. Vetë



— Drejt Zotit

kryekapellani i ushtrisë amerikane në Vietnam, prifti gjeneral-major Çarls Braun, vendosi të bëjë ndërhyrje energjike në Uashington. Pas dy ditëve, në zyrat e selisë së shenjtë të kryepeshkopit Spellman arriti një letër, pak a shumë, si kjo:

«Shërbëtori i juaj ju shqetëson. Shërbëtori juaj ju lutet ta dëgjoni... Shenjtëri! Ashtu siç kemi patur guximin t'ju vëmë në dijeni edhe herë të tjera, puna jonë po vështirësohet nga një ditë në tjetrën. Ju keni patur mirësinë e zemërgjersinë të na dërgoni dy herë me radhë, gjatë këtyre dy muajve të fundit, kontigjente të reja, por përsëri ato nuk mjaftojnë. Të 274 priftërinjtë që shërbejnë në ushtrinë tonë, këtu në Vietnamin e Jugut, me ndihmën tuaj dhe të Zotit kanë bërë të gjitha përpjekjet për të lehtësuar jetën e përtejme të bijve të Amerikës që bien mbi këtë tokë të mallëkuar. Por, shenjtëria juaj e lartë, rrethana të pamvarura nga ne po e bëjnë punën tonë gjithnjë e më të vështirë. Këtu gjithçka shtohet. Shtohen ushtarët tanë, shtohet edhe numri i atyre që kanë nevojë për bekimin tonë. Kapellanët tanë të mjerë, si shërbëtorë të Zotit, janë të detyruar të fluturojnë për ditë të tëra me helikopterë, nga një vënd beteje në tjetrin dhe secili prej tyre të drejtojë pesëdhjetë herë një javë shërbesat fetare. Kini parasysh, o zoti ynë i plotfuqishëm, se numri i ushtarëve tanë, që vendosën ta ndërrojnë këtë botë me botën tjetër, është rritur sa asnjë herë gjer më sot. Në shtatë muajt e këtij viti ranë në fushën e betejës 63 përqind e të gjithë ushtarëve tanë, që kanë rënë në luftën vietnameze gjer më sot. Dhe sa më shumë shtohet numri i atyre që shkojnë për të gjetur

prehjen e përjetshme, aqë më tepër shtohet për-
mallimi e nostalgjia e atyre që presin në radhë.
Në këto rrethana, kur dora e satanait përgjon në
çdo shkurre, qoshe rruge e kthese shtëpie, ne e
shohim me sytë tona se çfarë efekti të mrekullu-
eshëm bën një meshë, ose një bekim i thjeshtë i
priftit për ata që janë vënë në rrjesht e do të
nisen për betejë, nga ku, ndofta nuk do të kthehen
me këmbët e tyre. Si bij të edukuar me parimet e
lirive tona të mëdha, ata e vështrojnë priftin me
lot në sy dhe kërkojnë të gjejnë në fjalët e tij
ngushëllim. Në fjalët magjike të njeriut me rendi-
gotë të zezë e të kopsitur gjer në grykë, me jakë
të bardhë e me syza të errta, bijtë e Amerikës
në Vietnamin e Jugut gjejnë atë ushqim shpirtëror
që i bën të besojnë në jetën e siguar të përtejme.
Këta ushtarë — krijesa të Perëndisë, tani i shikon
të shëndetshëm duke bredhur nëpër rrugë ose të
vënë në rrjesht përpara kazermave, ndërsa pas një
ore ose pas një dite, ata mund t'ja falin shpirtin
lirisë sonë e të bëhen martirë. Ne duhet të bëjmë
çmos që ata të vdesin si bij të denjë të Krishtit.
Amen!... Kini parasysh shenjtëria e juaj se, në
këtë luftë në xhungël edhe kisha jep martirët e
saj. Rasti i Dog Bellicit («Paqa e përjetshme qoftë
mbi të») nuk është i veçuar. Ky dhe shumë të tjerë
duhet të na bëjnë të mendojmë. Ndofta ka ardhur
koha të mekanizohen edhe meshat e përsheptjet
fetare? Ata të shërbimit psikologjik të ushtrisë sonë
duhet të mendojnë për ndonjë aparat, që të sigu-
rojë prezencën tonë shpirtërore në çdo njësi të
ushtrisë, edhe kur ato janë në fushën e betejës.
Mendoni për gjëndjen e vështirë të shërbëtorëve

tuaj në këtë tokë të nëmur që digjet flakë si ferri. Mos u kurseni të na dërgoni përforcime të reja shenjtorësh (talentet më të mira), për të varrosur si të krishterë të mirë ata që vijnë 15 mijë kilometra larg, për të sjellur paqen e përjetshme për vete dhe për fëmijët vietnamezë, që janë pushtuar nga nënat dhe baballarët e tyre. Dëgjojeni, o i plotëfuqishëm, lutjen e shërbëtorit tuaj besnik e të përulur. Amen!»

Shtator, 1966.


ENDËR NË SHTËPINË E BARDHË

Në aerodromin Tan Son Nhut të Saigonit uleshin radhë radhë aeroplanë në formë kryqi, të mbësh-tjellë me ca kordhele të mëdha shumëgjyreshe, që formonin fjalët «Fitore». Ishte mesditë, dielli shkël-qente fort, por fishekzjarrët nuk kishin të sosur; ato ngjiteshin valë valë në qiell dhe, në vënd të shpërthimeve, formonin ca zëra qiellorë. Një pa-rashikues i fatit, në prag të vitit të ri, i kish shpie-guar këto zëra me fjalët «Mirseardhët». Ndërkohë, në portin e Saigonit, vaporët shkarkonin disa arka, që nuk u ngjanin aspak arkivolëve të zakonshëm të ushtarëve. Prapa tyre vinin rrjeshta vajzash gjysmë të zhveshura, pjesë përbërëse e delegacioneve të tokës-mëmë, që kishin ardhur për të marrë pjesë në ceremoninë e fitores në tokën-bijë. She-shet qenë kthyer në fusha parade dhe qindra mijë vietnamezë binin në gjunjë e tundnin në ajr tufa lulesh në forma të çuditshme, jo në formën e bom-bave me sahat.

Ardhja e presidentit u kthye në ngjarje aqë të gëzueshme sa që njerëzit u gajasën së qeshuri. Në-për rrugë dhe në çdo hotel, zyrë ose kazermë ame-rikane u vunë kurora gjigande. Më e madhja u vu në ambasadë. Disa mijëra gazeta qarkullonin

nëpër qytet me tituj e germa nga një metër të lartë, që i thurnin lavde ushtrisë fitimtare, lirisë që sollli ajo në majën e bajonetave të veta ngadhënjyese dhe që flisnin për besnikëri të pafund të popullsisë vendëse ndaj shpëtimtarëve. Disa telegrame përgëzimi, që kishin ardhur prej vëndeve të ndryshme të botës, qenë varur nëpër shtyllat e larta, që kufizoheshin me retë dhe binin në tokë, duke lëshuar hie të gjata mbi kuadratet e ushtarëve amerikanë të radhitur për paradë. Një telegram nga Santo Domingo thoshte: «Juve, shpëtimtarëve të Vietnamit, ju ftojme të rrini sa më shumë tek neve, për të mirën e lirisë». Një telegram tjetër nga Evropa i lutej Zotit që presidenti Xhonsen të ketë mirësinë t'i japë leje shtabit të Natos t'i ngrerë çadrat e veta përsëri në Paris, ndërsa luani britanik njoftonte se, më në fund, munda ta hedhë La Manshin e të dalë në kontinent. Por njoftimi që i jepte gjallërinë më të madhe ceremonisë ishte angazhimi i mis Amerikës për vitin 1966, e cila njoftonte se, dërgonte në Vietnam tetëqind mijë të puthura — dy për çdo ushtar amerikan, me tri-dhjetë përqind zbritje nga çmimi mesatar.

Për një çast, vështrimet e turmës u përqëndruan përsëri në qiell. Nga thellësitë e pafundme, me shpejtësinë e vetëtimës, po zbriste një aparat i çuditshëm që kish formën e një pjate fluturuese. Aparati zbriti tek këmbët e presidentit me aq shpejtësi sa që shërbimet e radarit nuk qenë në gjëndje të japin asnjë të dhënë paraprake. Nga pjata fluturuese dolën tre pasagjerë të paparë ndonjëherë. Secili prej tyre ishte dyzet e tetë centimetra i gjatë, me kokë trekëndëshe e fytyrë të gjelbërt dhe, çka ishte më



Presidenti i gjithësis

interesante, ata ishin me nga një këmbë e me nga pesë duar secili. Për të zhdukur çdo keqkuptim, ata bënë prezantimin menjëherë. Nga një kuti që lëshonte xixa verbonjëse, nxorën një letër të shkruar... në gjuhën engleze. Letra thoshte:

«Naltmadhërisë së tij Lindon Xhonson, president i imperatorisë Amerika, planeti — Tokë.

«Imperatoria e bashkuar Marsiana ju dërgon përshëndetjet më të përzemërta për fitoren me rëndësi ndërplanetare. Me ndihmën e aparaturave shumë të perfeksionuara ne jemi në dijeni të ngjarjeve në sipërfaqen e fqinjës sonë dhe pronës suaj — Tokë. Në bazë të ligjeve të gravitetit dhe të bashkëveprimit reciprok të galaktikës sonë, ngjarje të tilla ndodhin vazhdimisht edhe tek ne. Edhe ne përpiqemi t'u japim lirinë banorëve të planetit tonë, përpiqemi për të ruajtur pastërtinë e racës «marsiana», për t'iu siguruar të gjithëve një vënd të rehatshëm mbi ose nën sipërfaqe. Po mos kujtoni se çdo gjë shkon mirë dhe urtë e butë. Ka edhe tek ne nga ata që nuk i kuptojnë të mirat e qytetërimit të imperatorisë sonë. Prandaj ju propozojmë që të bashkërendisim forcat. Ne jemi gati të lejojmë disa baza ushtarake të imperatorisë suaj në hapësirën tonë dhe të nënëshkruajmë një pakt si ai i Atlantikut, të shoqëruar me një «aleancë për përparim». Delegacioni ynë vjen aty me shpresë se do të gjejë mirëkuptimin tuaj të plotë.

Imperatori i Marsianës»
(firma e palexueshme)

Pasi dëgjoi mesazhin, presidenti u kthye menjëherë nga mysafirët. Ata, nga ana e tyre, lëshuan disa klithma që, siç duket, shprehnin gëzim, duke ngritur të gjitha duart përpjetë. Din Rasku, që ndodhej pothuajse në qendër të ngjarjeve që po zhvilloheshin, i tha presidentit me zë të ulët: «Qenkan shumë të përshtatshëm për në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, sepse secili na siguron pesë vota». Ideja ishte me leverdi dhe aty për aty u vendos të pranohen anëtarë të OKB-së. Presidenti urdhëroi pastaj të mblidhej me urgjencë këshilli i gjeneralëve për të studjuar klauzolat e paktit me planetin mik. Nën rrezet e diellit shkëlqenin kokat tullace të gjeneralëve, të përkulur mbi hartat. Njëra prej këtyre kokave me siguri i përkiste gjeneralit Uestmorlend, strategut të fitores në Vietnam. Nuk kishte asnjë dyshim se ajo kokë do të caktohej për të kryesuar delegacionin, që do të shkonte në Marsiana.

Parada po fillonte. Nga gjiri i turmës shkëputet një skuadër ushtarësh amerikanë me mëngë të përveshura, pantallona të shkurtëra e kokën e qethur rrafsh. Ndo njeri prej tyre mbante në dorë një kokë të prerë dhe çdo kokë e prerë përfaqësonte vullnetin e njërit prej popujve të Indokinës, për t'u bashkuar me imperatorinë Amerika. Kokat i radhitën tek këmbët e presidentit. Presidenti u emocionua nga gëzimi, ngriti dorën drejt qiellit e thirri me të madhe:

— Mrekulli! Mrekulli!

Mjeku, bashkë me majorin Xhejms që qëndronte gjithmonë pranë dhomës së gjumit të presi-

dentit, hyri brenda me nxitim. Presidenti ish zbuluar përgjysmë. Krahët i kish hedhur në të dy anët e shtratit dhe sytë e zgurdulluar i kish përqëndruar në një pikë në tavan. Dukej si një kryq. Merrte frymë shpejt dhe gulçonte. Doktor i vrapoi pranë shtratit dhe mori t'i shikonte pulsën.

— Ah, sa keq! Paska qenë ëndër!

— Qetësohuni, sër. Ëndrat gjithmonë dalin në të kundërtën! — tha doktori, ndërsa po i numëronte të rrahurat e pulsit.

ZEZAKËT DHE SENATORËT

Fjalimi i senatorit Llong vazhdoi dhjetë orë e një minutë. Me hap të sigurtë ai u ngjit në tribunë në orën dy të ditës dhe, duke iu marrë këmbët nga lodhja, u largua nga tribuna kur sahati i madh në mur shënoi mesnatën. Për dhjetë orë, Llonga mundi të lexojë disa kapituj nga Bibla, kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me të gjitha shtojcat e spjegimet përkatëse, nja dy kapituj të revistës së byrosë meteorologjike si edhe disa faqe nga libri i telefonave të qytetit Kolumbia. Ai desh të lexojë edhe një artikull mbi beisbollin, por nuk mundi: e la zëri. Tashmë ai lëviz buzët po askush nuk kupton gjë, duket sikur flet me vete në gjumë. Vëndin e Llongut e zuri senatori Dirks, i cili, duke iu përkulur kryetarit të mbledhjes në shënjë respekti, afroi nga vetja librin e telefonave...

Në këtë kohë, salla pothuajse ishte boshatisur e vetëm aty këtu dremiste ndonjë senator, prapa tavolinave të modelit të vjetër si ato të dirigjentëve të orkestrës. Të tjerët kishin hequr xhaketat e flinin në koridore, nëpër kanape. Shërbyesit e senatit vraponin të zgjonin nga gjumi senatorët që gërhisnin... Po agonte mëngjesi i ditës së gjashtë,

që kur senati amerikan po vazhdonte mbledhjen e tij të pandërprerë, kushtuar shqyrtimit të projektligjit mbi të drejtat e zezakëve.

Praktika e senatit të SHBA, midis shumë kombinacioneve të pashëmbëllta, njih edhe një kombinacion me titull «Flibustjer», që don të thotë fjalime të pandërprera. Kuptimi i fjalës «Flibusters», në pamjen e jashtme, duket sikur ka pësuar një metamorfozë të plotë në fjalorin amerikan. Por vetëm në pamjen e jashtme. Dikur në Amerikë me këtë emër quanin piratët e detit. Më vonë filluan të quhen kështu pushtonjësit amerikanë në Amerikën Latine. Dhe, në ditët tona, xhentëlmenët senatorë nuk e kanë për të keq të marrin mbi vete, si emër të dytë, fjalën «Flibustjer». Del se pirateria mund të ushtrohet jo vetëm në det e në tokë, por, në shkallë edhe më të gjërë, në senat.


Në faqet e fjalorëve etimologjikë «Flibustjeri» ze jo më shumë se tri rrjeshta, ndërsa në senatin amerikan zen çdo vit javë të tëra, bile javët më intensive, në qoftë se mund të thuhet se senatorët punojnë ndonjë herë intensivisht.

Për të vënë në jetë këtë fjalë magjike, vepron sipas një skenari të veçantë. Komedia fillon shtruar e thjeshtë, me prezantimin e personazheve; pastaj gjallërohet në faqet e gazetave dhe mbaron me një flakë kashte në sallat e senatit. Skenari i komedisë merr fill atë ditë, kur njerin prej senatorëve (ta zëmë, senatorin Xhonson) e caktojnë kandidat për president në zgjedhjet e ardhëshme presidenciale. Xhonsoni vihet përballë senatorit tjetër Nikson ose Gollduoter. Senatori Xhonson fillon gjuetinë e votave. Meqënëse dhjetë milionë

zezakët janë një pyll i përshtatshëm gjuetie në fushatën elektorale, kandidati për president lëshon një balon letre, si përkrahës i të drejtave të zezakëve. Në senat ai paraqet një projekt-ligj. Fillon diskutimi i projekt-ligjit. Krijohet barrikada e kundërshtarëve të projekt-ligjit. Ata mbajnë si flamur «Flibustjerin». Ulen pranë mikrofonit dhe, duke e shfrytëzuar «të drejtën e fjalës», flasin e flasin, natë e ditë, gjersa afati për shqyrtimin e projektit mbaron.

Pak më sipër, përmënda emrin e senatorit Xhonson. Për t'i vënë gjërat në vendin e vet, duhet thënë se Xhonsoni në fjalë tani mban postin e presidentit të SHBA. Gjashtë vjet më parë, Xhonsoni e nisi fushatën e tij elektorale me paraqitjen e projekt-ligjit mbi të drejtat e zezakëve. Pas 79 orë diskutimesh, projekti u shty «për më vonë». Meqënëse formula «për më vonë», po të deshifrohet, do të thotë hedhje në shportë, projekti nuk u përmënd më. Tani atë e përdorin senatorët e tjerë, si një grep të ndryshkur, për të peshkuar vota sa herë që bëhen zgjedhje në senat, ose për fushatën e ardhshme elektorale të vitit 1968. Vetë Xhonsoni ka harruar për krijesën e tij fatkeqe. Ai e hodhi lumin. Në Amerikë ka një rregull të përgjithshëm, që thotë: «Kandidati premtton — presidenti harron». Shpesh herë, tregëtarët ambulante dalin nëpër rrugë, duke mbajtur një tabelë të tillë: «Blejme mallra me kredi. Garancia është e plotë. Firma jonë e mban fjalën. Pronari ynë nuk është kandidat për president.»

Kësaj radhe e hodhi grepin senatori Mensfilld, që ëndëron kurorën e Shtëpisë së Bardhë, ose të



paktën një vënd sa më afër kurorës. Projekti i tij mbi të drejtat e zezakëve parashikonte nene shumë të bujshme: barazi në zgjedhjen e gjyqtarëve lokalë, dhe në marrjen e shtëpive me qira!

Megënëse dhënia e lirive të tilla të pashëm-bëllta zezakëve mund të «lëkundë nga themelet parimet e pronës së shënjtë private në Amerikë» (siç u shprehën disa senatorë), filloi «flibustjeri». Mensfilldi bëri përpjekje titanike triditore për të mbledhur 51 senatorë (nga njëqind), të shpërndarë nëpër lokalet publike. Dhe me qënëse ai mundi ta realizojë me sukses edhe këtë detyrë me të vërtetë të vështirë, qëllimi u arrit. Mensfilldi shpallet përkrahës i zezakëve! Në qoftë se projekti i tij mbeti përsëri projekt, faji nuk është i Mensfilldit. Rolet janë të ndarë. Së shpejti mbyllet sesioni i kongresit. Kundërshtarët e projektit i kanë bërë llogaritë. Në qoftëse arrijnë ta mbushin këtë kohë me fjallime çfarëdo, projekti futet në ndonjë dosje të ndonjë nënkomisioni... Në nëndor bëhen zgjedhjet e reja, fillon sesioni i ri. Projekt-ligji mbi të drejtat e zezakëve harrohet, kurse lufta kundër zezakëve vazhdon.

Fakti që, edhe kësaj radhe, nuk qe e mundur të aprovohej një ligj në favor të zezakëve, nuk do të thotë në asnjë mënyrë se senatorët amerikanë janë kundra çdo ligji. Përkundrazi, ligjet amerikane shtrihen aq larg, gjer në... mbrojtjen e minjve. Në shtetin Kalifornia, për të përdorur kurthin e minjve, duhet pa tjetër (në bazë të ligjit) të kesh leje gjuetie! A nuk është ky një shëmbull? Se fundja, nuk do të kish «botë të lirë» sikur të mos kish minj, Litëll-Rok, Alabama, Misisipi, Ku-

Klus-Klan ose guvernatorë si Uolles, që shkon e bën roje vetë në portat e shkollave, për të mos lejuar «përzjerjen» e racave në sallat e mësimit... Të gjitha janë të lejueshme dhe të gjitha mund të ngjasin në «botën e lirë», vetëm një gjë nuk mund të ndodhë: që presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qoftë edhe vetëm në njërin prej fjajlimeve të tij, të harrojë të flasë për të drejtat e njeriut. Kjo nuk mund të ndodhë. Zemërgjërësia e Xhonsonëve duket se është me të vërtetë e pafund, po të kihet parasysh ajo çka po ndodh me dhjetë milionë zezakët amerikanë, këto vitet e fundit.

Nëndor 1966

MINISTRAT, POLICËT DHE... MINJTË!

Kryeministërja e Indisë, Indira Gandi, ua hodhi fajin minjve për krizën e tanishme të bukës në Indi.

(Nga shtypi)

Në Indi po ndodhin disa ngjarje që mund të hyjnë në listën e gjërave të padëshirueshme — zi buke, vdekje nga uriya, demonstrata, parulla të shkruara në mure kundër qeverisë. Policia ka një mbingarkesë në shërbimet e veta.

Ministrat e qeverisë u mblodhën për të studiuar gjëndjen e për të marrë masa. Ata u ulën në formë rrethi e këmbëkryq, mbi minderllëke të mbuluar me pëlhurë të bardhë. Edhe veshja e ministrave ishte në përputhje të plotë me ambientin. Shallvaret e takijet, gjithashtu të bardha, i jepnin mbledhjes pamje solemne.

Kjo mbledhje duhej të hynte në histori, murrëpo njeri nga oratorët sikur e vuri në dyshim atë që po ndodhte. Ai tha:

— Ne jemi mbledhur për të diskutuar një problem që nuk ekziston. Kam dëgjuar të flitet poshtë e lart se trazirat në shtetet tona qenkan shkak-

tuar nga mungesa e sendeve ushqimore. Unë mund t'ju vërtetoj me shkencë, se njerëzit që vuajnë nga uria nuk kanë takat të dalin nëpër rrugë e të protestojnë, aq më pak të ndeshen fizikisht me policët tanë aq të shëndetshëm. Shkaku i turbullirave duhet kërkuar gjetkë.

Të gjithë vështruan njeri tjetrin në sy. Subaraja merr vesh nga këto gjëra, sepse ai kryeson dikasterin e ushqimeve e të bujqësisë.

— Po, po, zotërinj, — mori zjarr oratori — njerëzit që vuajnë nga uria nuk kanë fuqi të ngrihen as në këmbë e jo më të ngrënë zërin aq lart, siç po dëgjojmë këto ditë nëpër rrugët e qyteteve e të fshatrave tona. Shumë të nderuarit zotrinj, që merren me drejtimin e policisë, duhet t'i japin një spjegim kësaj çështjeje, se këtu ka diçka që vetëm ata mund ta spiegojnë.

— Juve mos kujtoni se policia ka mbetur pas, i nderuari koleg — ndërhyri njëri nga të pranishmit. — Ne kemi zbuluar mijëra elementë subversivë, të cilët shtiren si të uritur për të arritur qëllime të tjera. Bile, disa syresh bëjnë sikur vdesin nga uria, për të na mashtruar e për të na shkaktuar telashe. Po ne ua rregullojmë qejfin atyre. Ju e dini fort mirë, zotrinj, se shumë endacakëve, që sulmuan depot qeveritare të drithrave, ne ua mbushëm barkun me barut.

Të gjithë qeshën të kënaqur nga ndërhyrja e ministrit të policisë.

Titullari i dikasterit të riteve fetare e të kastave dha një mendim origjinal.

— Unë jam për ruajtjen e traditës — tha ai. — Mjafton që njerëzit të mbajnë parasysh traditat



MINJTË — Dhe për ne mendon kryeministrja.

tona dhe çdo gjë do të eci qetë dhe mbarë e mirë. Gjithë bota ka dëgjuar për fakirët indjanë që i mohojnë vetes gjithçka, duke ndenjur në heshtje të plotë. Unë e di një fakir që ka ndenjur dyzet ditë i shtrirë lakuriq mbi një grumbull xhamash të thyer, dhe hante vetëm njëqind gram bukë në ditë. Është e vërtetë se ai shkoi në botën e përtejme, por, ama, nuk bëri as gëk as mëk. Ndërsa e nderuara qeveria jonë, me përpjekjet që vetëm ajo mund t'i bëjë, iu jep njerëzve nga 250 gram bukë në ditë, pa llogaritur këtu gjethet e rrënjët e bimëve që po i hanë pa para. Përse bëhet zhurmë? Ku është tradita e fakirëve tanë?

Për një çast, këto pyetje mbetën të varura në ajr. Argumenti ishte i pakundërshtueshëm. Të gjithë i kthyen sytë nga kryetarja e mbledhjes. Ajo bëri një xhest me dorë, sikur do t'i qortonte të pranishmit. Ai xhest impononte urtësi në shqyrtimin e problemit. Me tonin e një profeti, ajo tha:

— Zotrinj! Problemi duket se ekziston. Bile mund të themi se ekziston me siguri. Po, a keni menduar ndonjë herë përse mungon drithi në vëndin tonë? Më parë duhet gjetur shkakun, zotrinj, dhe vetëm pastaj të shqyrtojmë pasojën. Unë vë re se disa zotrinj të nderuar harruan disa qënie shumë të vogla që lozin një rol shumë të madh në vëndin tonë. E kam fjalën për... minjtë! Po, po, për minjtë e zakonshëm të fushave apo të kuzinave. Ata dhe vetëm ata janë fatkeqësia jonë kombëtare. Ata janë një e keqe e tmershme, që njerëzit nuk e marin dot me mënd. Ah sikur të mos ishin këta brejtës të pamëshirshëm! Minjtë hanë një të katërtën e drithit tonë. Dikush përpjet.

t'ua hedhë fajin çifligarëve. Diçka me të vërtetë e habitshme, po të marrim parasysh se minjtë hanë edhe drithin e çifligarëve. Për fat të keq, minjtë janë qenie që nuk dijnë të bëjnë dallime... Unë kam dëgjuar ta kritikojnë qeverinë tonë edhe pse nuk cakton fonde për bonifikime dhe se shumë toka nuk mund të mbillen. Kjo është kritika më pa përgjegjësi që kam dëgjuar gjer më sot. Kjo do të thotë që ne të mbjellim toka për të ushqyer minjtë...

Kryeministërja e spiegoi edhe më tej çështjen e minjve. Por ndërkaq Çaudhuri dhe Maja bënë një propozim «të ri». Kur erdhi fundi i mbledhjes, të gjithë qenë dakord, që në programin e zgjedhjeve të caktohen dhe të merren masa të jashtëzakonshme për të luftuar armikun kryesor. U vendos që të bëhen investime të mëdha për ngritjen e industrive moderne për prodhimin e kurtheve të minjve, për hapjen e një fushate madhështore kombëtare, e cila do të zhvillohet kryesisht nëpër zgavrat e tokës e vrimat e kuzinave, të ndërmerren edhe masa urgjente për sterilizimin e meshkujve. Kështu, kur të vijë dita që minjtë të mos gjejnë asnjë kokër drithë gjëkund, populli indian do të mundë të jetojë «si jo më mirë».

Janar, 1967.

RRËFIMI I PODGORNIT

— monolog —

Presidenti i Sovjetit Suprem të BRSS, Podgorni, bëri një vizitë në Vatikan dhe bisedoi me Papën, vetëm për vetëm, më se një orë.

(Nga shtypi)

O At i Shenjt, më jepni bekimin!

Tregoni zemërgjerësinë tuaj të pakufishme. Tregohuni mëshirëplotë ndaj birit tuaj të përulur e të penduar, që vjen t'ju puthë dorën e t'ju kërkojë ndihmë. Njeriu, në çastet më të vështira të jetës, drejtohet tek ju me shpresë të zjarrtë.

O Atë i Shenjtë! Falnani mëkatet tona, që i përkasin asaj të kaluare, që ne të gjithë, nuk e dëshirojmë të kthehet. E kaluara jonë ishte vetëm një lajthitje e përkohëshme e djalit plangprishës, që tani përulet para veladonit tuaj. Ju betohem për këto libra, që na rrethojnë e që përmbledhin gjithë urtësinë e botës¹. Ajo që dikur na ndante,

1) Takimi u bë në bibliotekën private të Papës.

tani na bashkon. Ne jemi përpjekur ta tregojmë pendimin tonë me vepra, që shenjtëria juaj i ka bekuar me aq ngrohtësi. Të pesë mesazhet e një pasnjëshme të paraardhësit tonë, — Nikita, drejtuar shenjtërisë, paraardhësit tuaj — Joan, qenë dallëndyshet e para të asaj, që quhet ndërtimi i urave midis jush dhe nesh. Që kur duart e shenjta të paraardhësit tuaj përkëdhelën flokët e shkaktuan lotë mallëngjimi në sytë e bijës së paraardhësit tonë, këtu e tre vjet më parë, zemrat na dridhen për bujarinë që tregoi përfaqësonjësi i Perëndisë në tokë. Jini i sigurtë, o Atë i Shenjtë, se ju keni lënë mbresa të paharrueshme edhe tek ministri ynë i punëve të jashtme, kur patët mirësinë ta prisnit në këtë sallë të shenjtë e ta takonit në Amerikë.

Na falni, o Atë i Shenjtë, për sjelljen e ashpër që treguam, në të kaluarën, ndaj engjëllit tuaj, imzot Slipitit, ish metropolit i Lvovit, vetëm e vetëm se pat bashkëpunuar me gjermanët, gjatë pushimit të Ukrainës. E cili nga ne, bijt e Perëndisë, nuk ka pësuar lajthitje në jetë? Shenjtëria juaj na e kthjelloi mëndjen për të qenë të urtë dhe shenjë e pendimit tonë është po vetë imzot Slipiti, që u lejua të kthehet në gjirin e folesë hyjnore, këtu në Vatikan, e të kryesojë seksionin rus. Shenjtori Slipit tani ka mundësinë të shikojë me sytë e tij se tek ne ka shumë miq. Nëqoftëse e quan të arësyeshme e të virtytëshme shenjtëria juaj, imzot Slipiti ose ndonjë engjëll tjetër si ai, mund të dërgohet përfaqësuesi juaj personal në Kremlin. Ne jemi gati të ndërtojmë pjesën e urës që na takon, ose edhe të gjithë atë, mjafton që shenjtëria juaj të japë aprovim.

Unë e di se mund të bëhem tri herë mëkatar, kur flas për ato shërbime aq të vogla, që nuk meritojnë vemendje; por e di, gjithashtu, se durimi juaj është i pakufishëm për të dëgjuar atë që ju flet me zemër në dorë.

O Atë i Shenjtë! Ju jeni përfaqësuesi i Atij, që u kryqëzua për të mirën e njerëzimit. Ndihmouni në luftën tonë të përbashkët, kundër atyre heretikëve që duan të turbullojnë botën me luftën e klasave, duke prishur e çrregulluar rendin. Dje ata nuk besonin në urtësinë e Xhonit dhe sot njo-llisin figurën e ndritur të Lindonit. Me urtësinë tuaj ju gjithmonë i keni dënuar të pabindurit. Tregouni atyre vendin e Xhiordano Brunos e të Galileut. Hidhuni anathemën atyre që shkojnë kundër të plotëfuqishmit dhe nuk duan të veprojnë e besojnë si ne.

Në fjalimet tuaja, o Atë i Shenjtë, ne mësojmë se mbi të gjitha duhet urtësia. Keqbërësin vraje me urtësi, se edhe nëqoftëse ai sot të shkel, nesër ose pasnesër do ta kuptojë se nuk është mirë. A nuk janë të gjithë njerëzit vëllezër? Bashkëekzistenca jonë është mishërimi i enciklikave tuaja të paqës.

O Atë i Shenjtë, na akuzojnë se neve iu ndihmojmë amerikanëve për të qetësuar Vietnamin. Ku ka gjë më të mirë se qetësia! Bijt e Perëndisë janë edhe amerikanët. Të gjithë një shpirt kemi. E ç'faj kemi ne që përpiqemi t'u lehtësojmë vuajtjet të gjithë bijve të Perëndisë? Emisarët tuaj gjithmonë janë sakrifikuar në emër të vendosjes së asaj qetësie, që ju aq shumë e dëshironi.

Ndihmonani, o Atë i Shenjtë, të kemi një botë tonën. Demokracia juaj kristjane është pasqyra, ku ne shohim të ardhmen në rendin tonë.

Amen!

Shkurt, 1967.

RUANI KOKËN, SËR!

Më në fund, edhe Kabot Lloxhit i erdhi koha të merret me memuare. Ç'është e vërteta ai e ka filluar këtë punë edhe më parë, por detyra e ka ndërprerë herë pas here vazhdimin e kësaj ndërmarrjeje me aq leverdi. Në jetën e vet atij i ka qëlluar shumë herë të kthehet në «ish», po kësaj radhe duket se kjo parashtesë do të mbetet e pandryshueshme. Dhe, siç e dini, është një zakon perëndimor që njerëzit si Lloxhi, sapo kthehen në «ish», fillojnë nga memualet, kthehen në pleq të urtë e japin këshilla gjithfarëshe — që nga punët botërore e gjer tek mënyrat e organizimit të reklamit të sallameve. Lloxhi është tri herë «ish»: ai qe kandidat për zëvendës president të SHBA me 1960 dhe një «ish» në katror e mori në Vietnam, duke qenë dy herë ambasador.

Po çështja e memuaeve i përket së ardhmes. Në këto ditë, kur po shkëmbehen përsëri kuajt amerikanë në Saigon, ky ish «specialist i vendimeve të mëdha dhe lojtar i mirë në kumarin politik», (siç cilësohej dikur), është i zënë me hartimin e «testamentit» për pasardhësin e vet Banker. Edhe në qoftëse Kabot Lloxhi, gjatë karrierës së tij, nuk qe në gjëndje të «marrë vendime të mëdha» dhe ta

lozi «kumarin politik» ashtu si duhet, ai prapë është i nevojshëm; — në mos për tjetër, të paktën për të treguar se si e ndjen veten një amerikan në Saigon.

Disa paragrafe të «testamentit» të Lloxhit, në adresë të Bankierit, do të mund të hartoheshin, pak a shumë, në këtë mënyrë:

«... Sër! Pikësëpari ju uroj të ktheheni i gjallë në Amerikë. Unë për vete, këtë e quaj suksesin kryesor të karrierës sime në Vietnam. Në moshën 73 vjeçare, siç jeni ju, i nderuar koleg, duhen kursyer jo vetëm ditët, por edhe minutat e jetës. Aq më tepër, si i martuar rishtas... Këshilla ime numër një, është: Në çdo rast e rrethanë përpikuni të mos bini në sy si amerikan. Paraqituni si të dëshironi, por jo si janki. Mos banoni kurrë në katet e ulta të ndërtesës së ambasadës, se ju goditin me predhën e parë, po në asnjë mënyrë mos u ngjitni as në katet e sipërme, se, në rast atentati, e keni shumë të vështirë të zbrisni poshtë. Që të mos harroni këto porosi, mbani gjithmonë parasysh fytyrën e Xhonsonit (mos e ngatërroni me presidentin, unë e kam fjalën për ndihmësin tuaj Aleksis Xhonson), i cili edhe sot e kësaj dite i ruan shenjat e predhave në serrat, nga sulmi që iu bë ambasadës sonë dy vjet të shkuara. Ai le të shërbejë si një pasqyrë, ku çdo mëngjes ju të shihni fytyrën tuaj. Mos dilni nëpër rrugë, mos hyni nëpër kafe e restorante, edhe atëhere kur ju duket se atje ka vetëm amerikanë. Ky vend është një mister; një ferr i vërtetë. Mos shkelni nëpër trotuaret dhe mos hypni në asnjë maqinë. Mos hypni as edhe në helikoptere, se ata fluturojnë shumë afër

tokës. Mos pranoni të hapni asnjë zarf me duart tuaja dhe mos provoni të prekni i pari objektet në tavolinën e punës... Në depot tona ka plot thasë nejloni për mbështjelljen e kufomave dhe, me siguri, do t'ju sjellin të tjera. Shteti ynë ka menduar për ne të gjithë. Por nuk uroj që ndonjëri prej këtyre thasëve t'u bjerë juve në pjesë. Ruajeni veten, sër!

Mos u besoni shërbëtorëve. Më duket se njerin prej tyre e quajnë Ki. Ai është këlyshi ynë dhe neve këlysh na duhet dhe jo qen, por mbajeni nën vëzhgim. Ata hanë njeri tjetrin dhe mirë bëjnë, po kjo na shkakton telashe. Është e vështirë të punosh në një vënd, ku nuk mban mënd as emrin e kryeministrit. Gjatë këtyre dy-tre vjetëve të fundit, ambasada jonë ka emëruar dymbëdhjetë kryeministra, dhe unë shpesh jam i detyruar të pyes sekretarët se si e quajnë këtë apo atë. (Historia do ta tregojë se sa kam vuajtur).

Porosia e fundit, sër, ka të bëjë me optimizmin. E them nga eksperiencia personale, presidenti ynë do njerëz optimistë. Edhe kur e shikon se punët shkojnë në drejtim krejt të kundërt me atë që presim e duam ne, shpallni hapur se gjithçka shkon në rregull. Mos u besoni atyre ngjarjeve që ndodhin në frontet e luftës. Qëndroni besnik parrimit tonë të përgjithshëm: Sa më keq, aq më mirë. Në fjalorin e një ambasadori në Saigon nuk ekzistojnë as aeroplanë të rrëzuar, as ushtarë amerikanë të vrarë, as tunele të padepërtueshme e toka të pakontrolluara. Këto janë shpikje të vietnamezëve. Ndiqni shembullin e presidentit në të gjitha deklaratat. Edhe nëqoftëse ndonjë ditë, rastësisht,

do të bindeni se disfata është e paevitueshme, ju mos e pranoni. (**Shenim:** E përdora shumë herë me rradhë fjalën «mos», por këtë e bëj për hir të jetës suaj, të ledit tuaj të pafajshme dhe të Amerikës»).

Pasi vuri pikën, ambasadorit të «vendimeve të mëdha» iu duk vetja triumfues. Në fund të fundit, po kthehej i gjallë. Se, nuk është shaka të kthehesh i gjallë nga lufta e humbur.

Mars, 1967.

KURRIZI I GAMILES

Këta dy heronj ju i njihni prej kohësh. Ata janë po ai Xhon Bull dhe po ai Daj Sam që, herë pas here, përmenden nëpër gazetat, e sidomos në revistat satirike. Shpesh i shohim në poza të ndryshme. Herë ndryshojnë fytyrën, herë fushën e veprimtarisë. Ata janë miqtë më të ngushtë të karikaturistëve.

Daj Sami, nga një herë, del në publik me pantallona të varura në dy rrypa, që i bien nga supet, i mbulojnë barkun e bëshëm që, për çudi, mbështet mbi dy këmbë të holla. Kapella e tij gjithmonë është sa një çadër nga ato të plazhit e që ka të gjitha ngjyrat e shenjat e flamurit amerikan. Herë të tjera ai është një plak thatim, me sytë të futur thellë, me mjekër të rrallë e agresive, si ajo e cjamin. Dhe kur del me këtë uniformë, të gjithë e dinë se Daj Sami është i zemëruar, se, në këta raste, ai mban në duar gjëra shumë serioze — si bie fjala, predha të mëdha që kanë pothuajse gjithnjë të shënuar germën «A». Në këto raste duket sikur plakut i mungojnë disa rruaza të shtyllës kurrizore dhe diçka e padukshme e tërheq drejt tokës.

Xhon Bulli është edhe më i rraskapitur. Koha ka lënë gjurmë të theksuara tek ai. Dhe duket si e pabesueshme që një herë e një kohë ai e hiqte

veten për luan, bile jo nga ata luanët e zakonshëm, po luan deti. Madje, edhe tani, në ditët tona, ish-
luani i ruan ende disa karakteristika të vjetra dhe
ne e shohim të shëtisë nëpër faqet e shtypit bo-
tëror, po me atë kurorë të dikurshme si peliçe me
lesh të rënë, e po me atë bisht me tufë në majë,
veçse me fije të rralluara.

Daj Sami, shpesh, e përdor peliçen e Xhonit
për tu ulur mbi të, prandaj nuk është për t'u
çuditur që fytyra e Xhonit tregon gjithnjë lodhje,
dëshpërim e lutje. Të shumtën e kohës ai e kalon
shtrirë. Po kjo nuk do të thotë se ai nuk di të
zemërohet. Sot, përshëmbëll, ai është shumë i tron-
ditur. Shkak për këtë është Daj Sami, i cili, me-
gjithse e heq veten si më të ri vazhdon të mos
e përfillë, e bile ta qortojë gjyshin. (Se ata, për-
veç të tjerave, janë edhe farë e fis).

Xhon Bullit i pëlqen të flasë shpesh për ish-
rininë e tijë. Është e vërtetë se ajo kohë tashmë i
duket si një vegim i largët, po kur s'ke ç'të tregosh
tjetër, edhe historitë mbi të kaluarën hyjnë në punë.

— Ju dini vetëm të na akuzoni — ngriti zërin
Xhon Bulli, duke iu dridhur buza e poshtme. Fjalët
i dilnin të ndara në rrokje të veçanta dhe çdo
tingull e pasonte një si bisht i padukshëm, si fish-
këllimë. — Ju nuk keni hiç parasysh se...

— Çfarë ju? — ndërhyri Daj Sami, pa pritur ta
mbaronte fjalën Xhon Bulli.

— Ju rekomandoj të lexoni edhe një herë Zhyl
Vernin — vazhdoi Xhon Bulli me zërin që dilte si
nga fundi i pusit. — Po, po, Zhyl Vernin të lexoni.
Atje do të gjeni një farë Fileas Fog. Ai, ai... për
tetëdhjetë ditë i ra botës qark. Gjysmën e atij udhë-
timi e bëri pa u larguar nga imperatoria jonë en-

gleze (Këtu mori frymë thellë). Po, po... Pa u larguar nga imperatoria jonë. Nga Franca në Suez, prej andej në Aden, pastaj, i hypur në elefant, i ra përmes Indisë, prej andej në Singapor dhe doli në Amerikën veriore. Kudo, në Aden, në Suez, në Kalkuta, ate e pritën nëpunësit tanë, dua të them nëpunësit e mbretërisë sonë. (Këtë e theksoi fort, sikur të donte të tërhiqte vemendjen e bashkëbiseduesit mospërfillës). Imperatoria britanike nuk iu nda Fileas Fogut gjatë gjithë udhëtimit tij. Fati i miliona njerëzve, nga qoshet më të largëta të botës, vendosej në zyrat tona. Ja këtu, në Londër...

Xhon Bulli mori frymë thellë dhe iu duk se u lehtësua. Tani donte qetësi. Puls i rrihte shpejt. Ndjeu se iu ngrit tensioni. Mirëpo Daj Sami, sikur ta bënte nga inati, vuri duart në ije dhe ia plasi të qeshurit me sa fuqi kish. Barku i doli më në pah dhe rrudhat e fytyrës iu palosën dëndur si një fustanellë. Në atë moment ai i përngjiste shumë Adenauerit.

— Të shquara të harruara — tha Daj Sami me mospërfillje — Nuk të pyet kush si ke qenë, po si je.

— Edhe sot... edhe sot... foli Xhon Bulli, duke ngritur zërin — imperatoria jonë jo më kot quhet «Hirësia hyjnore, mbretëresha e mbretërisë së bashkuar, Zelandës së Re dhe zotërimeve e teritoreve të tjera, kryetare e Komenuelthit, mbrojtëse e besimit».

— Ende nuk e keni harruar këtë emër, sër? Më duket pak si i gjatë! — ndërhyri përsëri Daj Sami, me ton tallës.

— Unë nuk kam harruar as faktin që ju keni qenë kolonia jonë — gërthiti Xhon Bulli, gjithë zemërim.

— Ndërsa mua më pëlqen të merrem më shumë me të ardhmen. Dje lexova në një gazetë, sikur aty nga vitet shtatëdhjetë ju do t'i luteni Kongresit tonë t'iu pranojë në federatën amerikane, si shteti i 51-të. A është e vërtetë, sër?

Xhon Bulli u zbeh edhe më shumë në fytyrë. Ai kërkonte fjalë për të shprehur atë çka i ziente përbrenda, po bashkëbisedonjësi i tij vazhdonte të fliste pa e prishur gjakun.

— Kjo, — tha ai — do të na krijojë mjaft telashe në amerikanëve, por ama, do të na zgjidhë edhe një problem të rëndësishëm: do të krijohet një post i përshtatshëm për Robert Kenedin, si guvernator në Londër. Djalë me talent, sër!

Plaku englez vendosi të përdorë kartën e fundit. I duhej mbyllur goja këtij bashkëbisedonjësi të bezdisshëm e kokëfortë.

— Ç'kemi nga Vietnami, sër? — pyeti Xhoni, në mënyrë të papritur. — Thuhet se po shenoni përparime të mëdha...

— Ajo është edhe lufta juaj — u përgjegj Daja, duke bërë sikur nuk e kuptoi ironinë.

— Fuqi e madhe, helbete. Siç duket, gjithë arsenalin e Amerikës ka ndër mend të shpërngulet në xhunglat e Vietnamit.

— Vietnamin mos ma përmend — nisi të marrë flakë Daj Sami. — Ti shiko punët e tua. Ti ke në hundë kanalin e La Manshit e s'e kalon dot. Vetëm tridhjetë e tetë kilometra ju ndajnë nga kontinenti. Sportistët e të dyja sekseve, pas një stërvitjeje pak a shumë serioze, e mbulojnë me sukses këtë distancë. Ndërsa ti, o luan i deteve, ka disa vite që rreh të dalësh në bregun tjetër e s'del dot. Uilsoni juej endet si prifti me kusi nëpër

kryeqytetet e Evropës perëndimore, duke u lutur ta pranojnë në «tregun e përbashkët» dhe s'ja hapin portën.

— Ju e dini si është puna, ser — tha Xhon Bulli me zë vajtues. — Ata janë gjashtë e nuk duan të bëhen shtatë.

— Mua nuk më intereson se ç'duan e ç'nuk duan ata. Mua më intereson ajo që na duhet neve. Porta që nuk i gjendet çelësi, duhet thyer.

— Edhe neve, si juve, sër. Edhe ju keni ngrihur një komitet çarmatimi në Gjenevë, që e quani komiteti i të 18-ve, po ai gjithmonë ka mbetur komiteti i të 17-ve. Pse nuk e thyni atë 'karrige bosh, po i silleni për rreth?

— Në komitetin tonë vetëm një mungon — pohoi Daj Sami, me gjysmë zëri.

— Edhe neve ai «një» na pengon. Juve nuk iu vjen atje ku e thërrisni, neve nuk na fton atje ku duam. A nuk është njëlloj?

Veshët e Daj Samit kanë një cilësi, që nuk e ka asnjë vesh në botë: ata nuk dëgjojnë asgjë nga ato që nuk i intereson zotronjësit të tyre. Prandaj, edhe kësajë radhe, ai nuk u përgjigj, por kundërsulmoi:

— Uilsoni juej çdo javë flet për optimizëm, po në fakt nuk është gjë tjetër veçse një gamile, që e ka futur kokën në vrimën e gardhit, po kurrizi nuk e lejon as të ecë përpara, as të kthehet pas.

Ndërsa mua, — u hodh Xhon Bulli gjithë inđinjatë — presidenti juaj më duket si një elefant kockë e lëkurë, që ka hyrë në batak gjer në bark dhe gjatë çdo përpjekjeje për të dalë prej andej fundoset thellë e më thellë.

— Ju thashë edhe një herë: Vietnamin mos ma përmendni.

Për të ndërruar bisedën në favor të tij, xhaxhai amerikan vendosi të kthehet përsëri tek e para.

— Ser! Ne gjithnjë jemi kujdesur për sigurimin tuaj, jemi përpjekur që ju ta ndjeni veten sa më pranë nesh. Ne përsëri ju shtrijmë dorën tonë bujare: ju pranojmë si shteti ynë i pesëdhjetënjëjtë. Nëqoftëse kjo iu duket pa leverdi he për he, atëhere do të ndërhyjmë t'iu pajtojmë me fqinjën tuaj të përtej La Manshit. Franca nuk kërkon shumë për këtë, mjafton që Britania të heqë dorë nga Komenuelthi, të zevendësojë stërlinën me frangun, të anullojë gjuhën engleze, të shëmbë kolonën e Nelsonit, të heq dorë nga mbajtja e krahut të majtë në qarkullimin e automjeteve, t'i paguaj taksa ministrit francez të financave... Nuk janë kushte të vështira, ë?

Xhon Bullin përsëri e kapën të dridhurat. Nga inati filloi të shkuli qimet e peliçes së tij gjithë rogja. Ai do të dëshironte ta hante të gjallë këtë dajë të pamëshirshëm, po e përmbajti veten. Pasi lëshoi disa gulçima nëpër dhëmbë, tha me zë të ulët:

— Ju përpiquni të ruani bazat tuaja atje, sër. Më duket se këto ditë gjeneralët amerikanë i ngri-tën çadrat nga toka franceze. Apo gënjejnë gazetat?

Daj Sami e pa se vazhdimi i bisedës me këtë plak matuf ishte diçka e kotë.

— Eh, kurrizi i gamiles! E dija unë se ç'do ti!

Dhe u largua duke çaluar sa në njerën këmbë në tjetrën. Xhon Bulli u shtri, mbajti frymën e filloi të numërojë rrahjet e pulsit.

Prill, 1967.

4.180

LIBRARI E SHKOLLËS
DURRES

PASQYRA E LENDEËS

	Faqe
Zgjedhja e një presidenti	3
Dinamiti i markës «Uashington»	15
Papagallët	23
Ahmeti dhe Zhani	27
Buzëqeshja e kufomave	33
Tre veta në një barkë, duke llogaritur qenin	39
Përqaftimet e sprutit	44
Mjergulla e Londrës	50
Shqetësimet e Xhek Patersonit	57
Dialogu i të dënuarve	65
Vajtim në NATO	72
Kukumjaçkat	79
Mos bëni bisht!... ..	84
Lehja e tartabiqeve	90
Tuneli i errët	94
Lutja e kapellanit amerikan	103
Endër në Shtëpinë e Bardhë	109
Zezakët dhe senatorët	115
Ministrat, policët dhe... minjtë!	121
Rrefimi i Podgornit	126
Ruani kokën, sër!	130
Kurrizi i Gamiles	134